



UNIVERSITETI I PRISHTINES
"HASAN PRISHTINA"
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush Ndertesile Rektoratit, D000 • rishtine.R., publlike Kosoves Tel: +38
138244 83 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.:

Date:

836

02/07/2021

RAPORTI I VLERËSIMIT PËR DORËSHKRIMIN E PUNIMIT TË DIPLOMËS SË MASTER-it

Fakulteti	i Inxhinierisë Mekanike
Departamenti/Programi	Komunikacionit/Trafik dhe transport
Projektpropozimi	"Analiza e parametrave të trafikut në rrugët kryesore në komunën e Obiliqit"
Kandidati	Bsc. Bejtush Beqiri
Mentori	Prof. Dr. Beqir Hamidi
Aprovimi i Projektpropozimit në Këshillin e fakultetit	Datë: Vendimi me nr.:

Vlerësimi i dorëshkrimit:

Në bazë të vendimit të Dekanit të Fakultetit, 679/2-12 të datës 28.05.21 është formuar komisioni me këtë përbërje:

1. Prof. Ass. Dr. Ramadan Mazrekaj, kryetar,
2. Prof. Dr. Beqir Hamidi, mentor,
3. Prof. Asoc. Dr. Shpetim Lajqi, anëtar.

për vlerësimin e punimit Master me titull "*Analiza e parametrave të trafikut në rrugët kryesore në komunën e Obiliqit*" (*Analysis of traffic parameters on the main roads in the municipality of Obiliq*), të kandidatit Bsc. Bejtush Beqiri.

Pas kontrollimit të punimit të lartpërmendur Komisioni jep këtë:

RAPORT

Punimi me titull "*Analiza e parametrave të trafikut në rrugët kryesore në komunën e Obiliqit*" (*Analysis of traffic parameters on the main roads in the municipality of Obiliq*), është hartuar në 8 kapituj dhe është ilustruar përmes 97 figurave 47 tabelave dhe 38 diagrameve.

Në kapitullin e parë është bërë një hyrje për qytetin e Obiliqit karakteristikat infrastrukturore në këtë komunë ku përfshihen rrugët lidhëse të qytetit me fshatra, rrjeti hekurudhor, parkingjet, transporti urban dhe mobiliteti.

Në kapitullin e dytë është treguar gjendja aktuale e rrugëve dhe kryqëzimeve në komunën e Obiliqit janë dhënë pikat ku do të shqyrtohen kryqëzimet që kanë fluks më të madh të qarkullimit në plan shtrirje si dhe epen sqarimet e rëndësisë së kryqëzimeve.

Në kapitullin e tretë është treguar gjendja aktuale e sinjalizimit në komunën e Obiliqit si dhe do të epen disa njohuri rreth sinjalizimit në përgjithësi.

Në kapitullin e katër është bërë analiza e gjendjes aktuale në të cilën analizë është bërë numërimi i pjesëtarëve të komunikacionit për tërë javën ku janë nxjerr ditët karakteristike (e hënë, e premte dhe e diele) dhe në të cilat ditë është bërë numërimi në tri orët karakteristike në bazë të tyre janë bërë diagramet dhe është nxjerr ora kulmore.

Në kapitullin e pestë është bërë llogaritja e nivelit të shërbimit të nëntë kryqëzimeve për gjendjen aktuale në formë analitike dhe përmes softuerit SimTraffic.

Në kapitullin e gjashtë është dhënë propozimi për përmirësimin e gjendjes aktuale për nëntë udhëkryqet dhe është bërë llogaritja e propozimit në të cilën është dhënë edhe niveli i shërbimit dhe paraqitja e plan shtrirjes përmes programit AutoCad dhe Simtraffic.

Në kapitullin e shtatë janë dhënë përfundimi dhe rekomandimet për rrugët kryesore në komunën e Obiliqit dhe




Në kapitullin e tetë është dhënë literatura e huazuar për përfundimin e këtij punimi shkencor.

PËRFUNDIM

Në bazë të shqyrtimit të punimit Master, Komisioni për vlerësim konsideron se punimi është hartuar në nivel të duhur, i shtjelluar përmes figurave, tabelave dhe vizatimeve.

Prandaj, Komisioni për vlerësimin e punimit Master, të kandidatit Bsc. Bejtush Beqiri, me titull "Analiza e parametrave të trafikut në rrugët kryesore në komunën e Obiliqit" (Analysis of traffic parameters on the main roads in the municipality of Obiliq), mendon se i plotëson të gjitha kriteret për punim Master, prandaj i propozon që të jepet në diskutim publik.

Prishtinë, 23.06.2021 Komisioni:

1. 
(Prof. Dr. Beqir Hamidi, mentor)
2. 
(Prof. Ass. Dr. Ramadan Mazrekaj, kryetar)
3. 
(Prof. Asoc. Dr. Shpetim Lajqi, anëtar)

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”
FAKULTETI I INZHINIERISË MEKANIKE
PROGRAMI STUDIMOR: KOMUNIKACION RRUGOR



PUNIM DIPLOME

MASTER

Kandidati:
Bsc. Bejtush Beqiri

Mentori:
Prof. Dr. Beqir Hamidi

Prishtinë, 2021

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”
FAKULTETI I INXHINIERISË MEKANIKE
PROGRAMI STUDIMOR: KOMUNIKACION RRUGOR



PUNIM DIPLOME MASTER

TEMA:

**"ANALIZA E PARAMETRAVE TË TRAFIKUT NË
RRUGËT KRYESORE NË KOMUNËN E OBILIQIT"**

THESIS:

**"ANALYSIS OF TRAFFIC PARAMETERS ON THE
MAIN ROADS IN THE MUNICIPALITY OF OBILIQ"**

LËNDA: TEKNIKA E TRAFIKUT

Kandidati:

Bsc. Bejtush Beqiri

ID: 160808200019

Komisioni:

Kryetar: Prof. Ass. Dr. Ramadan Mazrekaj

Mentor: Prof. Dr. Beqir Hamidi

Anëtar: Prof. Asoc. Dr. Shpetim Lajqi

PËRMBAJTJA

ABSTRAKTI.....	13
1. HYRJE	14
1.1. Rrjeti rrugor i komunës së Obiliqit.....	15
1.2. Lidhja e Obiliqit me rrjetin ndërkombëtar	18
1.3. Rrugët nacionale	18
1.4. Transporti urban dhe mobiliteti	18
1.5. Parkingjet	19
1.6. Rrjeti hekurudhor.....	19
2. GJENDJA AKTUALE E RRUGËVE DHE KRYQËZIMEVE NË SEGMENTET E DHËNA	19
2.1. Kryqëzimi i formës “T” i rrugës “Vëllezërit Gërvalla” dhe “Hasan Prishtina” (Nr. 1)	20
2.2. Kryqëzimi i formës “T” i rrugës “Vëllezërit Frashëri” dhe “Hasan Prishtina” (Nr. 2)	22
2.3. Kryqëzimi i formës “T” i rrugës “Hasan Prishtina” dhe “Ferid Curri” (Nr. 3)	25
2.4. Kryqëzimi i formës “T” i rrugës “Hasan Prishtina” dhe “Durrësi” (Nr. 4)	27
2.5. Kryqëzimi i formës “T” i rrugës “Vashingtoni” dhe “Hasan Prishtina” (Nr. 5)	29
2.6. Rrethrotullimi tre degësh që lidh rrugët “Vicianum”, “Isa Boletini” dhe “Dëshmorët e Kombit” (Nr. 6).....	31
2.7. Kryqëzimi i formës “T” të rrugës “Vashingtoni” dhe “Ukshin Hoti” (Nr. 7)	33
2.8. Kryqëzimi i formës “+” të rrugëve “Ukshin Hoti”, “Vëllezërit Frashëri” dhe “Abdurrahmon Gërguri” (Nr. 8)	35
2.9. Kryqëzimi i formës “T” të rrugës “Ukshin Hoti” dhe “Vëllezërit Gërvalla”(Nr. 9).....	37
3. GJENDJA AKTUALE E SINJALIZIMIT NË SEGMENTET E DHËNA	39
3.1. Sinjalizimi vertikal	39
3.2. Shtylla dhe vendosja e shenjës së komunikacionit.....	40
3.3. Sinjalizimi horizontal	42
3.4. Shenjat gjatësore.....	43
3.5. Vijat e plota.....	43
3.6. Shenjat tjera në sipërfaqen e rrugës.....	43
3.7. Sinjalizimi ndriçues	44

3.8.	Gjendja aktuale e sinjalizimit horizontal dhe vertikal në Obiliq	46
4.	ANALIZAT DHE PROPOZIMET PËR PËRMIRËSIM E GJENDJES SE TRAFIKUT	49
4.1.	Niveli i shërbimit	50
4.2.	Përcaktimi i vonesave	52
4.3.	Llogaritja e d_3 - vonesa initiale e rendit të automjeteve (s/aut)	52
4.4.	Faktori i rregullimit të progresionit të togut te automjeteve	54
4.5.	Përcaktimi i shkallës së qarkullimit të ngopur	55
4.6.	Niveli i shërbimit për udhëkryq të sinjalizuar	57
4.7.	Trajtimi i kthimeve majtas	58
4.8.	Ndryshimi dhe intervalet e pastrimit	59
4.9.	Përcaktimi i kohëve të humbura	60
4.10.	Përcaktimi i dëshiruar i kohëzgjatjes së ciklit	60
4.11.	Shpërndarja e intervalit te gjelbër brenda ciklit	61
4.12.	Përcaktimi i kërkesave të sinjalit për këmbësorë	61
4.13.	Numërimi dhe ekuivalentimi	62
4.14.	Kapaciteti potencial i lëvizjes	63
4.15.	Kriteri i nivelit të shërbimit	63
4.16.	Autocad Civil 3d	65
4.17.	Softueri Synchro	65
4.18.	Variacionet brenda orës	66
4.19.	Faktori i orës së pikut	66
4.20.	Numërimi	67
4.20.1.	Kryqëzimi i formës “T” i rrugës “Vëllezërit Gërvalla” dhe “Hasan Prishtina” (Nr. 1)	68
4.20.2.	Kryqëzimi i formës “T” i rrugës “Vëllezërit Frashëri” dhe “Hasan Prishtina”(Nr. 2). 71	
4.20.3.	Kryqëzimi i formës “T” i rrugës “Hasan Prishtina” dhe “Ferid Curri” (Nr. 3)	74
4.20.4.	Kryqëzimi i formës “T” i rrugës “Hasan Prishtina” dhe “Durrësi” (Nr. 4)	77
4.20.5.	Kryqëzimi i formës “T” i rrugës “Vashingtoni” dhe “Hasan Prishtina” (Nr. 5)....	80
4.20.6.	Rrethrotullimi tre degësh që lidh rrugët “Vicianum”, “Isa Boletini” dhe “Dëshmorët e Kombit”(Nr. 6)	83
4.20.7.	Kryqëzimi i formës “T” të rrugës “Vashingtoni” dhe “Ukshin Hoti”(Nr. 7).....	86
4.20.8.	Kryqëzimi i formës “+” të rrugëve “Ukshin Hoti”, “Vëllezërit Frashëri” dhe “Abdurrahmon Gërguri”(Nr. 8)	89

4.20.9. Kryqëzimi i formës “T” të rrugës “Ukshin Hoti” dhe “Vëllezërit Gërvalla”(Nr. 9)	93
---	----

5. LLOGARITJA E NIVELIT TË SHËRBIMIT TË KRYQËZIMEVE TË SHQYRTUARA 96

5.1. Shqyrtimi i kryqëzimit të formës “T” të rrugës “Vëllezërit Gërvalla” me “Hasan Prishtina”(Nr. 1).....	96
5.2. Shqyrtimi për kryqëzimin e formës “T” të rrugës “Vëllezërit Frashëri” me “Hasan Prishtina”(Nr. 2).....	99
5.3. Shqyrtimi për kryqëzimin e formës “T” të rrugës “Hasan Prishtina” me “Ferid Curri” (Nr. 3)	102
5.4. Shqyrtimi për kryqëzimin e formës “T” të rrugës “Hasan Prishtina” me “Durrësi”(Nr. 4)	105
5.5. Shqyrtimi për kryqëzimin e formës “T” të rrugës “Vashingtoni” me “Hasan Prishtina”(Nr. 5).....	108
5.6. Shqyrtimi për rrethrotullimin tre degësh që lidh rrugët “Vicianum”, “Isa Boletini” dhe “Dëshmorët e Kombit”(Nr. 6).....	111
5.7. Shqyrtimi për kryqëzimin e formës “T” të rrugës “Vashingtoni” me “Ukshin Hoti”(Nr. 7)	113
5.8. Shqyrtimi për kryqëzimin e formës “+” të rrugës “Ukshin Hoti”, “Vëllezërit Frashëri” dhe “Abdurrahmon Gërguri”(Nr. 8)	117
5.9. Shqyrtimi për kryqëzimin e formës “T” të rrugës “Ukshin Hoti” me “Vëllezërit Gërvalla”(Nr. 9)	122

6. PROPOZIMET PËR PËRMIRËSIM TË UDHËKRYQEVE 126

6.1. Propozimi për përmirësim për kryqëzimin e formës “T” të rrugës “Vëllezërit Gërvalla” me “Hasan Prishtina (Nr. 1)	126
6.2. Propozimi për përmirësim për kryqëzimin e formës “T” të rrugës “Vëllezërit Frashëri” me “Hasan Prishtina”(Nr. 2)	127
6.3. Propozimi për përmirësim për kryqëzimet e formës “T” të rrugëve “Hasan Prishtina” me “Ferid Curri” dhe “Durrësi” (Nr. 3 dhe Nr. 4)	127
6.4. PROPOZIMI PËR PËRMIRËSIM PËR KRYQËZIMIN E FORMES “T” TË RRUGËS “VASHINGTONI” ME “HASAN PRISHTINA”(Nr. 5).....	128
6.5. Propozimi për përmirësim për rrethrotullimi tre degësh që lidh rrugët “Vicianum”, “Isa Boletini” dhe “Dëshmorët e Kombit”(Nr. 6).....	129
6.6. Propozimi për përmirësim për kryqëzimin e formës “T” të rrugës “Vashingtoni” me “Ukshin Hoti”(Nr. 7)	129
6.7. Propozimi për përmirësim për kryqëzimin e formës “+” të rrugës “Ukshin Hoti”, “Vëllezërit Frashëri” dhe “Abdurrahmon Gërguri” (Nr. 8).....	130

6.8.	Propozimi për përmirësim për kryqëzimin e formës “T” të rrugës “Ukshin Hoti” me “Vëllezërit Gërvalla”(Nr. 9)	139
6.9.	Paraqitja e tërë rrjetit me nivelet e shërbimit	140
6.10.	Paraqitja e rrjetit rrugor përmes softuerit Simtraffic	141
7.	PËRFUNDIMI DHE REKOMANDIMET	143
	LITERATURA	144
	DEKLARATË E STUDENTIT PËR PUNË ORIGJINALE	145

LISTA E FIGURAVE

Figura 1.1: Harta e Obiliqit me rrugët kryesore[1]	17
Figura 2.1: Harta e rrjetit rrugor në qytetin e Obiliqit	20
Figura 2.2: Vendndodhja e udhëkryqit “1” i paraqitur në plan shtrirje përmes shenjës “●” ...	21
Figura 2.3: Gjendja ekzistuese e udhëkryqit “1”	21
Figura 2.4: Fotografimi i udhëkryqit përgjatë rrugës “Hasan Prishtina” në drejtimin Perëndim-Lindje	22
Figura 2.5: Fotografimi i udhëkryqit përgjatë rrugës “Vëllezërit Gërvalla” në drejtim të kyçjes me rrugën “Hasan Prishtina”	22
Figura 2.6: Fotografimi i udhëkryqit përgjatë rrugës “Hasan Prishtina” në drejtimin Lindje-Perëndim	22
Figura 2.7: Vendndodhja e udhëkryqit “2” në plan shtrirje i paraqitur përmes shenjës “●” ...	23
Figura 2.8: Gjendja ekzistuese e udhëkryqit “2”	23
Figura 2.9: Fotografimi i udhëkryqit përgjatë rrugës “Hasan Prishtina” në drejtimin Lindje-Perëndim	24
Figura 2.10: Fotografimi i udhëkryqit përgjatë rrugës “Vëllezërit Frashëri” në drejtim të kyçjes me rrugën “Hasan Prishtina”	24
Figura 2.11: Fotografimi i udhëkryqit përgjatë rrugës “Hasan Prishtina” në drejtimin Perëndim-Lindje	24
Figura 2.12: Vendndodhja e udhëkryqit “3” në plan shtrirje i paraqitur përmes shenjës “●” .	25
Figura 2.13: Gjendja ekzistuese e udhëkryqit “3”	25
Figura 2.14: Fotografimi i udhëkryqit përgjatë rrugës “Hasan Prishtina” në drejtimin Lindje-Perëndim	26
Figura 2.15: Fotografimi i udhëkryqit përgjatë rrugës “Hasan Prishtina” në drejtimin Perëndim-Lindje	26
Figura 2.16: Fotografimi i udhëkryqit përgjatë rrugës “Ferid Curri” në drejtim të kyçjes me rrugën “Hasan Prishtina”	26
Figura 2.17: Vendndodhja e udhëkryqit “4” në plan shtrirje i paraqitur përmes shenjës “●” .	27
Figura 2.18: Gjendja ekzistuese e udhëkryqit “4”	27
Figura 2.19: Fotografimi i udhëkryqit përgjatë rrugës “Hasan Prishtina” në drejtimin Lindje-Perëndim	28
Figura 2.20: Fotografimi i udhëkryqit përgjatë rrugës “Durrësi” në drejtim të kyçjes me rrugën “Hasan Prishtina”	28
Figura 2.21: Fotografimi i udhëkryqit përgjatë rrugës “Hasan Prishtina” në drejtimin Perëndim-Lindje	28
Figura 2.22: Vendndodhja e udhëkryqit “5” në plan shtrirje i paraqitur përmes shenjës “●” .	29
Figura 2.23: Gjendja ekzistuese e udhëkryqit “5”	29
Figura 2.24: Fotografimi i udhëkryqit përgjatë rrugës “Washingtoni” në drejtim të kyçjes me rrugën “Hasan Prishtina”	30
Figura 2.25: Fotografimi i udhëkryqit përgjatë rrugës “Hasan Prishtina” në drejtimin Perëndim-Lindje	30

Figura 2.26: Fotografimi i udhëkryqit përgjatë rrugës “Hasan Prishtina” në drejtimin Lindje-Perëndim.....	30
Figura 2.27: Vendndodhja e udhëkryqit “6” në plan shtrirje i paraqitur përmes shenjës “●”.	31
Figura 2.28: Gjendja ekzistuese e udhëkryqit “6”	31
Figura 2.29: Fotografimi i udhëkryqit përgjatë rrugës “Vicianum”	32
Figura 2.30: Fotografimi i udhëkryqit përgjatë rrugës “Dëshmorët e Kombit”.....	32
Figura 2.31: Fotografimi i udhëkryqit përgjatë rrugës “Isa Boletini”	32
Figura 2.32: Vendndodhja e udhëkryqit “7” në plan shtrirje i paraqitur përmes shenjës “●”.	33
Figura 2.33: Fotografimi i udhëkryqit përgjatë rrugës “Ukshin Hoti” në drejtimin Jug-Veri .	33
Figura 2.34: Fotografimi i udhëkryqit përgjatë rrugës “Vashingtoni” në drejtim të kyçjes me rrugën “Ukshin Hoti”.....	34
Figura 2.35: Fotografimi i udhëkryqit përgjatë rrugës “Ukshin Hoti” në drejtimin Veri-Jug .	34
Figura 2.36: Vendndodhja e udhëkryqit “8” në plan shtrirje i paraqitur përmes shenjës “●”	35
Figura 2.37: Fotografimi i udhëkryqit përgjatë rrugës “Ukshin Hoti” në drejtimin Jug-Veri .	35
Figura 2.38: Fotografimi i udhëkryqit përgjatë rrugës “Ukshin Hoti” në drejtimin Veri-Jug .	36
Figura 2.39: Fotografimi i udhëkryqit përgjatë rrugës “Vëllezërit Frashëri” në drejtim të kyçjes me rrugën “Ukshin Hoti”	36
Figura 2.40: Fotografimi i udhëkryqit përgjatë rrugës “Abdurrahmon Gërguri” në drejtim të kyçjes me rrugën “Ukshin Hoti”	36
Figura 2.41: Pozicioni i udhëkryqit “9” i paraqitur përmes shenjës “●”.....	37
Figura 2.42: Gjendja ekzistuese e udhëkryqit “9”	37
Figura 2.43: Fotografimi i udhëkryqit përgjatë rrugës “Ukshin Hoti” në drejtim të kyçjes me rrugën “Vëllezërit Gërvalla”	38
Figura 2.44: Fotografimi i udhëkryqit përgjatë rrugës “Vëllezërit Gërvalla” në drejtimin Veri-Jug.....	38
Figura 2.45: Fotografimi i udhëkryqit përgjatë rrugës “Vëllezërit Gërvalla” në drejtimin Jug-Veri.....	38
Figura 3.1: Ndarja e sinjalizimit[2].....	39
Figura 3.2: Dimensionet e shtyllave pjesës së fundmit dhe shenjave[4, 6].....	40
Figura 3.3: Montimi i shenjave me mbajtës të shtrënguar me bulonë[4]	41
Figura 3.4: Detali i vendosjes, përbërja e shenjës dhe “fytyra” e saj[4, 7]	41
Figura 3.5: Mbajtësit e shenjave në shtyllë[4]	41
Figura 3.6: Mbajtësit e shtyllave për tabela të profilit alumin dhe profileve të galvanizuara[4]	42
Figura 3.7: Metodën e vendosjes së shtyllave[4].	42
Figura 3.8: Dimensionet e shenjave horizontale[9]	44
Figura 3.9: Semafori[8]	45
Figura 3.10: Semafori me shigjeta për lejim qarkullimi [8].....	45
Figura 3.11: Pozicioni i vendosjes së shenjave dhe semaforëve [8].....	46
Figura 3.12: Afërsia e zhdukjes së gjurmëve dhe gjendja e vendkalimit të këmbësorëve	47
Figura 3.13: Shtrirja e vendkalimit të këmbësorëve në rrugën “Vashingtoni”	47
Figura 3.14: Sinjalizimi horizontal në komunën e Obiliqit	48

Figura 5.1: Paraqitja e udhëkryqit “1” me të dhëna.....	96
Figura 5.2: Rezultatet e nxjerra nga analiza e kapacitetit të udhëkryqit “1” pa sinjalizim.	99
Figura 5.3: Paraqitja e udhëkryqit “2” me të dhëna.....	99
Figura 5.4: Rezultatet e nxjerra nga analiza e kapacitetit të udhëkryqit “2” pa sinjalizim. ..	102
Figura 5.5: Paraqitja e udhëkryqit “3” me të dhëna.....	102
Figura 5.6: Rezultatet e nxjerra nga analiza e kapacitetit të udhëkryqit “3” pa sinjalizim. ..	105
Figura 5.7: Paraqitja e udhëkryqit “4” me të dhëna.....	105
Figura 5.8: Rezultatet e nxjerra nga analiza e kapacitetit të udhëkryqit “4” pa sinjalizim. ..	108
Figura 5.9: Paraqitja e udhëkryqit “5” me të dhëna.....	108
Figura 5.10: Rezultatet e nxjerra nga analiza e kapacitetit të udhëkryqit “5” pa sinjalizim.	111
Figura 5.11: Paraqitja e udhëkryqit “6” me të dhëna.....	111
Figura 5.12: Rezultatet e nxjerra nga analiza e kapacitetit të udhëkryqit me rrethrotullim.	113
Figura 5.13: Paraqitja e udhëkryqit “7” me të dhëna.....	114
Figura 5.14: Rezultatet e nxjerra nga analiza e kapacitetit të udhëkryqit “7” pa sinjalizim.	116
Figura 5.15: Paraqitja e udhëkryqit “8” me të dhëna.....	117
Figura 5.16: Rezultatet e nxjerra nga analiza e kapacitetit të udhëkryqit “8” pa sinjalizim.	121
Figura 5.17: Paraqitja e udhëkryqit “9” me të dhëna.....	122
Figura 5.18: Rezultatet e nxjerra nga analiza e kapacitetit të udhëkryqit “9” pa sinjalizim.	124
Figura 6.1: Plan shtrirja me udhëkryqet e propozuara.....	125
Figura 6.2: Gjendja aktuale dhe propozimi i Kryqëzimit të formës “T” të rrugës “Vëllezërit Gërvalla” me “Hasan Prishtina”.....	126
Figura 6.3: Gjendja aktuale dhe propozimi i Kryqëzimit të formës “T” të rrugës “Vëllezërit Frashëri” me “Hasan Prishtina”	126
Figura 6.4: Gjendja aktuale dhe propozimi i kryqëzimeve të formës “T” të rrugëve “Hasan Prishtina” me rrugët “Ferid Curri” dhe “Durrësi”	127
Figura 6.5: Gjendja aktuale dhe propozimi i kryqëzimit të formës “T” të rrugës “Vashingtoni” me “Hasan Prishtina”	127
Figura 6.6: Gjendja aktuale dhe propozimi i rrethrotullimit tre degësh që lidh rrugët “Vicianum”, “Isa Boletini” dhe “Dëshmorët e Kombit”,.....	128
Figura 6.7: Gjendja aktuale dhe propozimi i kryqëzimit të formës “T” të rrugës “Vashingtoni” me “Ukshin Hoti”	129
Figura 6.8: Paraqitja e udhëkryqit “8” me të dhëna.....	130
Figura 6.9: Plani fazor	131
Figura 6.10: Përcaktimi i vëllimeve kritike të shiritave	132
Figura 6.11: Rezultatet e nxjerra nga analiza e kapacitetit të udhëkryqit “8” me sinjalizim.	137
Figura 6.12: Gjendja aktuale dhe propozimi i kryqëzimit të formës “+” të rrugëve “Ukshin Hoti”, “Vëllezërit Frashëri” dhe “Abdurrahmon Gërguri”.....	138
Figura 6.13: Gjendja aktuale dhe propozimi i Kryqëzimit të formës “T” të rrugëve “Ukshin Hoti” me “Vëllezërit Gërvalla”,	139
Figura 6.14: Paraqitja e rjetit me rezultatet e fituara nga llogaritjet e mësipërme	139

Figura 6.15: Paraqitja e shtrirjes së rrugëve dhe hartës përmes SimTraffic-ut e transferuar në 3D Modeling.....	140
Figura 6.16: Shtrirja e kryqëzimeve që lidhin rrugët “Hasan Prishtina” me rrugët “Vëllezërit Gërvalla” dhe “Vëllezërit Frashëri”.....	140
Figura 6.17: Shtrirja e kryqëzimeve që lidhin rrugët “Hasan Prishtina” me rrugët “Ferid Curri”, “Durrësi” dhe “Vashingtoni”.....	141
Figura 6.18: Shtrirja e rrethrotullimit.....	141
Figura 6.19: Shtrirja e kryqëzimit që lidh rrugët “Ukshin Hoti” me rrugët “Vëllezërit Frashëri dhe Abdurrahmon Gërguri” në anën e majtë dhe me rrugën Vëllezërit Gërvalla në anën e djathtë.....	141

LISTA E TABELAVE

Tabela 1.1: Rrugët, relacionet dhe gjatësia e tyre[1].	17
Tabela 3.1. Dimensionet e vijave të plota	43
Tabela 4.1: Niveli i shërbimit për kryqëzimet me sinjalizim dhe pasinjalizim	51
Tabela 4.2: Raporti V/C Tabela 4.3: Hapësirat për lëvizje dhe pritje për person.....	51
Tabela 4.4: Parametri i rregullimit të vonesës inkrementale për filtrimin apo matjen e sinjaleve të fluksit të lëvizjes përpara	54
Tabela 4.5: Vlerat e faktorit të rregullimit të progresionit - FP	54
Tabela 4.6: Formulatat për llogaritjen e faktorëve të qarkullimit të ngopur	56
Tabela 4.7: Përcaktimi i nivelit të shërbimit për udhëkryq të sinjalizuar	57
Tabela 4.8: Ekuivalenti i automjeteve për kthimet majtas, E_{km}	58
Tabela 4.9: Ekuivalenti i automjeteve për kthimet djathtas, E_{kdj}	58
Tabela 4.10: Ekuivalentimi	62
Tabela 4.11: Vlera e tf dhe tg	63
Tabela 4.12: Kufiri i nivelit të shërbimit sipas kriterit të kohës së humbur [8].	64
Tabela 4.13: Rezultatet e numërimit javor	67
Tabela 4.14: Numërimet e bëra nga data 19.10.2020 deri me datën 25.10.2020 për udhëkryqin “1”.....	68
Tabela 4.15: Qarkullimi i pjesëmarrëseve në orën kulmore për udhëkryqin “1”.....	70
Tabela 4.16: Numërimet e bëra nga data 26.10.2020 deri me datën 01.11.2020 për udhëkryqin “2”.....	71
Tabela 4.17: Qarkullimi i pjesëmarrëseve në orën kulmore për udhëkryqin “2”.....	73
Tabela 4.18: Numërimet e bëra nga data 02.11.2020 deri me datën 08.11.2020 për udhëkryqin “3”.....	74
Tabela 4.19: Qarkullimi i pjesëmarrëseve në orën kulmore për udhëkryqin “3”.....	76
Tabela 4.20: Numërimet e bëra nga data 09.11.2020 deri me datën 15.11.2020 për udhëkryqin “4”.....	77
Tabela 4.21: Qarkullimi i pjesëmarrëseve në orën kulmore për udhëkryqin “4”.....	79
Tabela 4.22: Numërimet e bëra nga data 16.11.2020 deri me datën 22.11.2020 për udhëkryqin “5”.....	80
Tabela 4.23: Qarkullimi i pjestarëve në orën kulmore për udhëkryqin 5.	82
Tabela 4.24: Numërimi bërë nga data 23.11.2020 deri me datën 29.11.2020 për udhëkryqin “6”.....	83
Tabela 4.25: Qarkullimi i pjesëmarrëseve në orën kulmore për udhëkryqin “6”.....	85
Tabela 4.26: Numërimet e bëra nga data 30.11.2020 deri me datën 06.12.2020 për udhëkryqin “7”.....	86
Tabela 4.27: Qarkullimi i pjesëmarrëseve në orën kulmore për udhëkryqin “7”.....	88
Tabela 4.28: Numërimet e bëra nga data 07.12.2020 deri me datën 13.12.2020 për udhëkryqin “8”.....	89
Tabela 4.29: Qarkullimi i pjesëmarrëseve në orën kulmore për udhëkryqin “8”.....	92

Tabela 4.30: Numërimet e bëra nga data 14.12.2020 deri me datën 20.12.2020 për udhëkryqin “9”	93
Tabela 4.31: Qarkullimi i pjesëmarrëseve në orën kulmore për udhëkryqin “9”	95
Tabela 5.1: Humbjet kohore dhe niveli i shërbimit për udhëkryqin “1”	98
Tabela 5.2: Humbjet kohore dhe niveli i shërbimit për udhëkryqin “2”	101
Tabela 5.3: Humbjet kohore dhe niveli i shërbimit për udhëkryqin “3”	104
Tabela 5.4: Humbjet kohore dhe niveli i shërbimit për udhëkryqin “4”	107
Tabela 5.5: Humbjet kohore dhe niveli i shërbimit për udhëkryqin “5”	110
Tabela 5.6: Humbjet kohore dhe niveli i shërbimit për udhëkryqin “6”	113
Tabela 5.7: Humbjet kohore dhe niveli i shërbimit për udhëkryqin “7”	116
Tabela 5.8: Humbjet kohore dhe niveli i shërbimit për udhëkryqin “8”	121
Tabela 5.9: Humbjet kohore dhe niveli i shërbimit për udhëkryqin “9”	124
Tabela 5.10: Tabela përmbledhëse	125
Tabela 6.1. Përpilimi vëllimeve ekuivalente për faza të caktuara	132
Tabela 6. 2: Llogaritja e detyrës	134
Tabela 6.3: Humbjet kohore dhe niveli i shërbimit për udhëkryqin “8”	137
Tabela 6.4: Krahasimi i rezultateve të propozimit të llogaritjes manuale dhe me SIMTRAFFIC	138

LISTA E DIAGRAMEVE

Diagrami 4.1: Jolineariteti javor	67
Diagrami 4.2: Jolineariteti i javor për hyrjen 1	69
Diagrami 4.3: Jolineariteti i javor për hyrjen 2	69
Diagrami 4.4: Jolineariteti javor për hyrjen 3	70
Diagrami 4.5: Jolineariteti i kryqëzimit të 1-rë për orën kulmore gjatë tërë javës.	70
Diagrami 4.6: Jolineariteti javor për hyrjen 1	72
Diagrami 4.7: Jolineariteti javor për hyrjen 2	72
Diagrami 4.8: Jolineariteti javor për hyrjen 3	73
Diagrami 4.9: Jolineariteti i kryqëzimit të 2-të për orën kulmore gjatë tërë javës.	73
Diagrami 4.10: Jolineariteti javor për hyrjen 1	75
Diagrami 4.11: Jolineariteti javor për hyrjen 2	75
Diagrami 4.12: Jolineariteti javor për hyrjen 3	76
Diagrami 4.13: Jolineariteti i kryqëzimit të 3-të për orën kulmore gjatë tërë javës.	76
Diagrami 4.14: Jolineariteti javor për hyrjen 1	78
Diagrami 4.15: Jolineariteti javor për hyrjen 2	78
Diagrami 4.16: Jolineariteti javor për hyrjen 3	79
Diagrami 4.17: Jolineariteti i kryqëzimit të 4-të për orën kulmore gjatë tërë javës.	79
Diagrami 4.18: Jolineariteti javor për hyrjen 1	81
Diagrami 4.19: Jolineariteti javor për hyrjen 2	81
Diagrami 4.20: Jolineariteti javor për hyrjen 3	82
Diagrami 4.21: Jolineariteti i kryqëzimit të 5-të për orën kulmore gjatë tërë javës.	82
Diagrami 4.22: Jolineariteti javor për hyrjen 1	84
Diagrami 4.23: Jolineariteti javor për hyrjen 2	84
Diagrami 4.24: Jolineariteti javor për hyrjen 3	85
Diagrami 4.25: Jolineariteti i kryqëzimit të 6-të për orën kulmore gjatë tërë javës.	85
Diagrami 4.26: Jolineariteti javor për hyrjen 1	87
Diagrami 4.27: Jolineariteti javor për hyrjen 2	87
Diagrami 4.28: Jolineariteti javor për hyrjen 3	88
Diagrami 4.29: Jolineariteti i kryqëzimit të 7-të për orën kulmore gjatë tërë javës	88
Diagrami 4.30: Jolineariteti javor për hyrjen 1	90
Diagrami 4.31: Jolineariteti javor për hyrjen 2	91
Diagrami 4.32: Jolineariteti javor për hyrjen 3	91
Diagrami 4.33: Jolineariteti javor për hyrjen 4	92
Diagrami 4.34: Jolineariteti i kryqëzimit të 8-të për orën kulmore gjatë tërë javës.	92
Diagrami 4.35: Jolineariteti javor për hyrjen 1	94
Diagrami 4.36: Jolineariteti javor për hyrjen 2	94
Diagrami 4.37: Jolineariteti javor për hyrjen 3	95
Diagrami 4.38: Jolineariteti i kryqëzimit të 9-të për orën kulmore gjatë tërë javës	95

ABSTRAKTI

Në këtë punim është bërë analiza e trafikut në rrugët kryesore të zonës qendrore në komunën e Obiliqit, pjesa e rrugëve dhe kryqëzimeve që do të shqyrtohen dhe të bëhen numërimet janë:

- Kryqëzimin e formës “T” të rrugës “Vëllezërit Gërvalla” me “Hasan Prishtina”,
- Kryqëzimin e formës “T” të rrugës “Vëllezërit Frashëri” me “Hasan Prishtina”,
- Kryqëzimin e formës “T” të rrugës “Hasan Prishtina” me “Ferid Curri”
- Kryqëzimin e formës “T” të rrugës “Hasan Prishtina” me “Durrësi”,
- Kryqëzimin e formës “T” të rrugës “Vashingtoni” me “Hasan Prishtina”,
- Rrethrotullimi tre degësh që lidh rrugët “Vicianum”, “Isa Boletini” dhe “Dëshmorët e Kombit”,
- Kryqëzimin e formës “T” të rrugës “Vashingtoni” me “Ukshin Hoti”,
- Kryqëzimin e formës “+” të rrugës “Ukshin Hoti”, “Vëllezërit Frashëri” dhe “Abdurrahmon Gërguri” dhe
- Kryqëzimin e formës “T” të rrugës “Ukshin Hoti” me “Vëllezërit Gërvalla”.

Për analizimin e këtyre kryqëzimeve janë marr të dhëna nga terreni me anë të numërimit të pjesëmarrëseve të trafikut që janë këmbësorë, çiklist, vetura dhe automjete të rënda do të bëhen llogaritjet dhe do të shfrytëzohen softuerët përkatës për modelimin dhe simulimin e gjendjes aktuale dhe propozimit për përmirësim.

Softuerët shfrytëzuar në këtë punim janë: Word dhe Excel nga pakoja e MS Office, AutoCad Civil 2012, MathCad dhe SimTraffic.

1. HYRJE

Komuna e Obiliqit shtrihet në pjesën skajore të rrafshit të pasur të Kosovës, 10 km në veri-perëndim të Prishtinës, qendër administrative, politike dhe universitare e Republikës së Kosovës. Ka një pozitë të mirë gjeografike dhe kufizohet me pesë komuna të tjera: komunën e Prishtinës, Fushë Kosovës, Drenasit, Vushtrrisë dhe Podujevës. Magjistralla Prishtinë-Mitrovicë (M2), Autoudha „Ibrahim Rugova“ e cila ka hyrje dhe dalje në fshatin Mazgit, (Aeroportin ndërkombëtar „Adem Jashari“ 23 km, Porti i Durrësit 264 km, Porti i Shëngjinit 233km. Dy linja hekurudhore (Fushë Kosovë - Shkupë, Fushë Kosovë - Pejë, Fushë Kosovë - Mitrovicë).

Obiliqi gjendet 10 km larg kryeqendrës së Kosovës , Prishtinës. Është i vendosur në mes të rrafshit të Kosovës afër lumenjve Sitnicë dhe Llap. Territori i Komunës së Obiliqit përbëhet prej formave të llojllojshme duke filluar nga fushat, terrenet e rrafshëta rreth lumit Sitnica dhe Llapi, kodrinave të ulëta , rrafshnaltave e deri te kodrat dhe malet.

Pjesa qendrore e territorit të Komunës shtrihet rreth lumit Sitnicë, që është një teren fushor me një pjerrtësi mesatare prej 0.7 m/km, ndërsa pjesët tjera të relievit në lindje shkojnë duke u ngritur në kodra e lugina të malit Qyqavica dhe në perëndim po ashtu në kodra dhe lugina, male të degëve të malit të Albanikut (Kopaonikut).

Nga tërë territori i Komunës afro 75 % është sipërfaqe e rrafshët dhe kodrinore ndërsa diku 25 % janë teren malor dhe atë kryesisht pjesët periferike territorit të cilat edhe kufizojnë komunën e Obiliqit me Komunën e Glllogocit dhe të Podujevës.

Komuna e Obiliqit është një qendër ekskluzivisht industriale, ku gjenden rezerva të mëdha të thëngjillit e cila shtrihet në mes të luginës së lumit Sitnicë dhe lumit Drenicë në një gjatësi prej rreth 32 km në drejtim veri-jug dhe një në gjerësi rreth 12 km. Deri më tani janë konstatuar rezerva rreth 13 miliardë tonelata.

Këtë sipërfaqe e përbën një reliev i ndryshëm, me terren malor, sipërfaqe fushore dhe të rrafshët me tokë pjellore. Pjesa qendrore shtrihet rreth lumit “Sitnica” dhe lumit “Llap”, ndërsa pjesët tjera të relievit në perëndim shkojnë duke u ngritur në kodra e lugina të malit Qyqavica dhe në veri, po ashtu, në kodra e lugina të malit të Kopaonikut (Albanikut).

Komuna e Obiliqit , shtrihet në afërsi të gjigantit të KEK-ut dhe si e tillë është një qendër ekskluzivisht industriale me rezerva të mëdha të linjitit. Kjo bën që Obiliqi te jete një ndër komunat më të ndotura në Kosovë [1].

1.1. Rrjeti rrugor i komunës së Obiliqit

Rrjeti rrugor në komunë ka një zhvillim shumë të volitshëm që i mundëson lidhje të shpejta me rrugë nacionale dhe rajonale. Nëpër komunën e Obiliqit kalon rruga nacionale që lidhë kryeqytetin, Prishtinën me Mitrovicën, ndërsa brenda territorit të komunës së Obiliqit kalojnë 7.8 km të kësaj rruge nacionale. Autoudha “Ibrahim Rugova” e cila ka hyrjen dhe daljen në

fshatin Mazgit përshkon qytetin e Obiliqit në pjesën perëndimore të territorit të komunës si dhe përveç lidhjes me Shqipërinë përmes saj bëhet qarkullim më i mirë dhe i shpejtë për në aeroportin “Adem Jashari”. Përgjatë territorit të komunës së Obiliqit kalojnë gjithsej 4.4 km të autoudhës. Përveç kësaj, ekzistojnë edhe rrugët regjionale të cilat lidhin Obiliqin me komunën e Fushë Kosovës, Podujevës dhe Vushtrisë. Brenda territorit të komunës së Obiliqit kalojnë gjithsej 21.2 km të kësaj rruge regjionale. Rrugët lokale – lidhin gjithsej 18 zona kadastrale. Nga gjithsej 1,663 segmente rrugore në territorin e komunës së Obiliqit në gjatësi të përgjithshme prej 244.1 km, rrugë të asfaltuara janë 114.123 km. Kurse të trajtuara me zhavorr ose rrugët të rendit të IV-të janë 60 km rrugë nëpër fshatra e lokalitete.

Nga gjithsejtë 20 vendbanime rrugët janë të asfaltuara duke përjashtuar ndonjë rrugicë. Po ashtu rreth 90% të banorëve jetojnë në vendbanimet që i kanë rrugët e asfaltuara. Në hartë mund të shihen vendbanimet e përfshira nga shërbimi i transportit publik (rrugor dhe hekurudhor), vija qarkulluese e transportit publik, rrugët e asfaltuara, të paasfaltuara dhe hekurudhat. Rruga nacionale N-2 Prishtinë-Mitrovicë kalon nëpër territorin e Komunës së Obiliqit dhe përfshinë gjatësinë rrugore 7 km'. Kjo rrugë lidhë territorin e kësaj komune dhe të kryeqendrës së saj me komunat tjera, atë të Prishtinës dhe të Vushtrisë. Kjo rrugë, si njëra ndër rrugët më të frekuentuara në Kosovë, plotëson parakushtin e domosdoshëm dhe ndër më të rëndësishmit për zhvillimin e gjithëmbarshtëm të komunës së Obiliqit. Rruga nacionale N2 është e asfaltuar por ka dëmtime të cilat kërkojnë riparime konstante për shkak të frekuencës së madhe të qarkullimit që zhvillohet në të. Vendbanimet nëpër të cilat kalon rruga nacionale N2 Prishtinë-Mitrovicë janë: Babimoc, Milloshevë, Llazarevë, Mazgit dhe Shkabaj.

Rrugët rajonale kryesisht janë rrugë të asfaltuara dhe kanë një shtrirje jo të gjerë në territorin e komunës së Obiliqit. Gjatësia e tyre është rreth 30 km dhe shtrihen në 8 vendbanime apo 40% të gjitha vendbanimeve të komunës. Shprehur në raport të numrit të popullatës, 38% e popullatës jeton në vendbanimet me rrugë të asfaltuara. Rrugët rajonale janë rrugë të asfaltuara dhe kanë rëndësi të madhe sepse mundësojnë qarkullimin e popullatës nga një vendbanim në tjetrin, andaj ka nevojë për rehabilitim, mirëmbajtje dhe shtrirje më të madhe të tyre në territorin e komunës.

Relacionet e rrugëve rajonale në komunën e Obiliqit janë:

- Rruga Milloshevë – Raskovë –Bakshi me gjatësi 2.5 km e cila bën lidhjen me komunën e Podujevës,
- Rruga Obiliq –Cërkvena Vodicë – Sibovc me gjatësi 4.7 km e asfaltuar në vitin 2004 nga MTPT (3 km' më herët të asfaltuara),
- Rruga Obiliq –Cërkvena Vodicë –Hade –Grabofc e ndërprerë për shkak të zonës së eksploatimit të mihjes sipërfaqësore Mirash –Bardh. me gjatësi 3 km,
- Rruga Obiliq –TC “B“ – Plemetin me gjatësi 4.0 km,
- Rruga Shkabaj –Obiliq –Milloshevë,
- Rruga Obiliq –Kryshec – Fushë Kosovë e ndërtuar në qershor 2006 dhe
- Rruga Breznicë –Kozaricë

Arteriet më të rëndësishme të trafikut rrugor nuk e anashkalojnë Komunën e Obiliqit, me që ajo është shumë afër asaj të Prishtinës. Hekurudha dhe rrugët automobilistike e lidhin

Prishtinën me Shkupin dhe Maqedoninë në jug si dhe me Serbinë në veri. Rrjeti hekurudhor në Kosovë ka momentalisht standard relativisht të ulët.

Lidhjet me qendrat tjera të Republikës së Kosovës bëhen përmes vijës hekurudhore: Fushë Kosovë - Pejë, Hekurudhës: Shkup - Mitrovicë dhe rrugës nacionale N2 Prishtinë – Mitrovicë- Serbi e cila kalon përbri Obiliqit.

Ndërtimi i autostradës ka rëndësi të madhe si për komunikacionin brenda Kosovës, ashtu edhe për lidhjet ndërkombëtare. Autostrada: Merdarë– Prishtinë - Morinë kalon nëpër territorin e Obiliqit. Rrjeti rrugor në Komunë ka një zhvillim shumë të volitshëm që i mundëson lidhje të shpejta me rrugë nacionale dhe rajonale.

Në Figurën 1.1 është paraqitur harta e Obiliqit me rrugët kryesore që përshkojnë qytetin të dhënat e të cilave janë treguar në Tabelën 1.1.

Rruga nacionale N2 Prishtinë-Mitrovicë dhe rrugët rajonale:

- Obiliq- Fushë Kosovë,
- Obiliq – Milloshevë-Besianë dhe
- Obiliq-Cërkvena Vodice – Sibovc – Shipitullë – Graboc-Drenas dhe rrugëve lokale (kryesisht të paasfaltuara).




Figura 1.1: Harta e Obiliqit me rrugët kryesore[1]

Tabela 1.1: Rrugët, relacionet dhe gjatësia e tyre[1].

Kategoritë e rrugëve	Relacioni	Gjatësia në km.
Nacionale	Shkabaj –Mazgit – Milloshevë – Babimoc	9
Rajonale	Obiliq –Milloshevë –Raskovë	8
	Obiliq-Kryshec	6
	Obiliq – Cërkvëna Vodice–Lajthishtë – Shipitullë –Grabofc	14
	Total	28
Lokale	Obiliq (qyteza)	25
	Obiliq-Mazgit	4
	Obiliq- Plemetin	4
	Breznice-Kozaricë	10
	Milloshevë – Raskovë -Bakshi	5
	Llazarevë- Subotiq	2.5
	Mazgit-Mazgit	3
	Lajthishtë -Hamidi	3
	Lajthishtë- Sibovc	5
	Total	61.5
Rrugët lokale të rendit të 4, të paasfaltuara	Brenda vendbanimeve	40

Komuna e Obiliqit ka punuar dhe është duke punuar në ndriçim publik për t'i ofruar qytetarit një lëvizje më të sigurt. Në territorin e komunës 56.50 km rrugë janë të pajisura me sistem të ndriçimit [1].

1.2. Lidhja e Obiliqit me rrjetin ndërkombëtar

Në territorin e komunës së Obiliqit kalon autoudha R7 (“Ibrahim Rugova”). Kjo autoudhë e tangjenton komunën e Obiliqit në pjesën veri-lindore. Në këtë pjesë gjendet edhe nyja e autoudhës që mundëson kyçje me rrugën nacionale N2 e pastaj edhe me rrugën rajonale R220. Po ashtu në pjesën e njëjtë kalon edhe rruga nacionale N2 që lidhë Prishtinën me qytetin e Mitrovicës. Përmes kësaj nyje, qyteti i Obiliqit krijon qasje në rrugët e karakterit më të lartë.

Ndërtimi i autoudhës s'ka rëndësi të madhe si për komunikacionin brenda Kosovës, ashtu edhe për lidhjet ndërkombëtare. Autoudha përshkon vendbanimet Kryshec, Obiliq, Mazgit dhe Llazarevë e cila përshkon një gjatësi prej 4.4 km [1].

1.3. Rrugët nacionale

Rrjeti rrugor i Obiliqit përveç se përfshin nyjën kryesore lidhëse ndërmjet autoudhëve R7 dhe N2, shërben edhe si qendër e lidhjes së rrugëve nacionale të Republikës së Kosovës. Lidhja e kryeqendrës me qytetin e Prizrenit dhe pikat kufitare në Morinë dhe Merdarë, mundësohet përmes rrugës nacionale N25.

Gjithashtu, rruga nacionale N-2 e cila lidh Prishtinën me Mitrovicën kalon në territorin e komunës së Obiliqit konkretisht në vendbanimet Obiliq, Mazgit, Milloshevë dhe Babimoc. Kjo rrugë është e ndërtuar viteve të fundit dhe ka dy korsi me nga dy shirita me një gjatësi 9 km dhe gjerësi 8 metra [1].

1.4. Transporti urban dhe mobiliteti

Shërbimi i transportit publik me autobus dhe me kombibus zhvillohet në të gjitha vendbanimet, me përjashtim të fshatit Mazgit. Shërbimi i transportit publik në territorin e komunës së Obiliqit është në një nivel të kënaqshëm. Për shkak të pozicionit (konfiguracionit), vendbanimi i vetëm i cili nuk është i mbuluar me transport publik është Mazgiti. Ky fshat nuk ka transport publik për shkak të pozicionit (konfiguracionit), mirëpo ka qasje (transport) nga M2 dhe rruga Hasan Prishtina [1].

1.5. Parkingjet

Në komunën e Obiliqit janë tri parkingje publike dhe disa kënde. Gjendje kjo e cila nuk i plotëson nevojat dhe shkaktohen shumë tollovi dhe bllokime të trotuareve. Për këtë arsye paraqitet nevoja për parkingje të reja, të cilat janë të parapara të kryhen vitet në vijim [1].

1.6. Rrjeti hekurudhor

Ka shtrirje në territorin e komunës së Obiliqit, por aktualisht nuk funksionon. Linja e transportit hekurudhor është shumë e vjetër, e ndërtuar qysh në vitin 1873 në relacionin Shkup – Mitrovicë, ndërsa në Obiliq si qendër gjeostrategjike e rrafshnaltës së Kosovës është ndërtuar stacioni hekurudhor grumbullues. Nëpër territorin e komunës së Obiliqit kalojnë dy linja të hekurudhave: linja Fushë Kosovë – Mitrovicë me tre stacione hekurudhore si ai i Kryshec, i Obiliqit dhe ai i Plemetit dhe linja Fushë Kosovë – Pejë me stacionin në Grabofc i Epërm. Gjendja ekzistuese e binarëve hekurudhor dhe e katër stacioneve ekzistuese hekurudhore është e keqe. Nga gjithsejtë 20 vendbanime në komunën e Obiliqit, vetëm në 4 vendbanime kalon rruga hekurudhore. Rrjeti hekurudhor- binaret hekurudhore kalojnë nga Kryshec-Obiliq- Plemetin dhe Grabofc i Epërm.

Në vendbanimet nëpër të cilat kalojnë binarët hekurudhor jetojnë 11316 banorë apo 42 % të banorëve të komunës. Riaktivizimi i linjave ekzistuese hekurudhore i mundëson komunës së Obiliqit lidhjen me komunat e Pejës, Mitrovicës dhe më tutje me Maqedoninë, Serbinë, Evropën që do të thotë se plotësohet një parakusht shumë i rëndësishëm për zhvillimin e gjithëmbarshëm të komunës[1].

2. GJENDJA AKTUALE E RRUGËVE DHE KRYQËZIMEVE NË SEGMENTET E DHËNA

Komuna e Obiliqit shtrihet në pjesën skajore të rrafshit të pasur të Kosovës, 10 km në veri-perëndim të Prishtinës, qendër administrative, politike dhe universitare e Republikës së Kosovës. Ka një pozitë të mirë gjeografike dhe kufizohet me pesë komuna të tjera: komunën e Prishtinës, Fushë Kosovës, Drenasit, Vushtrrisë dhe Podujevës. Magjistralla Prishtinë Mitrovicë (M2), Autoudha „Ibrahim Rugova“, e cila ka hyrje dhe dalje në fshatin Mazgit, (Aeroportin ndërkombëtar „Adem Jashari“ 23 km, Porti i Durrësit 264 km, Porti i Shëngjinit 233 km. Dy linja hekurudhore (Fushë Kosovë - Shkupë, Fushë Kosovë - Pejë, Fushë Kosovë -Mitrovicë).

Në tërë komunën gravitojnë 20 vendbanime të shtrira në 18 zona kadastrale: Obiliqi (i ri dhe i vjetër), Mazgiti i ultë, Mazgiti i Lartë, Llazareva, Millosheva, Bakshia, Raskova, Babimoci, Breznica, Kozarica, Plemetini, Hamidia, Siboci, Grabofci i Epërm, Shipitulla, Hadja, Dobrosellë, Leshkoshiq, Cërkvena Vodice dhe Kryshec, që janë të banuara me komunitete të përkatësive etnike si: Shqiptar, Serb, Rom, Ashkali, Egjiptas, Boshnjak, Turk, Goran.

Në Figurën 2.1 është paraqitur plan shtrirja e udhëkryqeve që është shqyrtuar në këtë punim udhëkryqe të cilat janë në lidhje direkte me vendbanimet që janë përmendur më lartë me qendrën e Obiliqit[1].




Figura 2.1: Harta e rrjetit rrugor në qytetin e Obiliqit

2.1. Kryqëzimi i formës “T” i rrugës “Vëllezërit Gërvalla” dhe “Hasan Prishtina” (Nr. 1)

Udhëkryqi ndodhet afër dyqanit për shitje të pajisjeve shtëpiake dhe punëtorisë ARS Bazuar nga matjet në terren vërejmë se kemi një ngarkesë të madhe me të gjitha kategoritë e pjesëmarrësve. Kjo ndodh për arsye se udhëkryqi gjendet në fillim të qendrës së qytetit ku lidhen hyrjet dhe daljet nga qyteti për në drejtim të Fushë Kosovë s dhe Prishtinës si dhe hyrjet që bëhen nga fshatrat një pjesë e Mazgitit, Kryshec dhe Shkabaj.

Gjendja infrastrukturore dhe e sinjalizimit horizontal dhe vertikal janë paraqitur në Figurat 2.2, 2.3, 2.4, 2.5 dhe 2.6 ku shihen pozicioni i udhëkryqit, shtrirja e tij dhe fotografimi i udhëkryqit në tri degët e tij të bëra në terren.



Figura 2.2: Vendndodhja e udhëkryqit “1” i paraqitur në plan shtrirje përmes shenjës “●”



Figura 2.3: Gjendja ekzistuese e udhëkryqit “1”



Figura 2.4: Fotografimi i udhëkryqit përgjatë rrugës “Hasan Prishtina” në drejtimin Perëndim-Lindje



Figura 2.5: Fotografimi i udhëkryqit përgjatë rrugës “Vëllezërit Gërvalla” në drejtim të kycjes me rrugën “Hasan Prishtina”



Figura 2.6: Fotografimi i udhëkryqit përgjatë rrugës “Hasan Prishtina” në drejtimin Lindje-Perëndim

2.2. Kryqëzimi i formës “T” i rrugës “Vëllezërit Frashëri” dhe “Hasan Prishtina” (Nr. 2)

Udhëkryqi ndodhet afër shtëpisë së shëndetit. Bazuar nga matjet në terren vërejmë se kemi një ngarkesë të madhe me të gjitha kategoritë e pjesëmarrësve. Kjo ndodh për arsye se udhëkryqi gjendet në pjesën e lidhjes së qendrës së qytetit me fshatrat të cilat janë: Caravodica, Leshkoshiqi, Hadeja, Shipitulla, Siboci, një pjesë e Hamidisë dhe Grabocit, si dhe mund të lidhet edhe me disa fshatra të Fushë Kosovës.

Gjendja infrastrukturore dhe e sinjalizimit horizontal dhe vertikal janë paraqitur në Figurat 2.7, 2.8, 2.9, 2.10 dhe 2.11 ku shihen pozicioni i udhëkryqit, shtrirja e tij dhe fotografimi i udhëkryqit në tri degët e tij të bëra në terren.



Figura 2.7: Vendndodhja e udhëkryqit “2” në plan shtrirje i paraqitur përmes shenjes “●”



Figura 2.8: Gjendja ekzistuese e udhëkryqit “2”



Figura 2.9: Fotografimi i udhëkryqit përgjatë rrugës “Hasan Prishtina” në drejtimin Lindje-Perëndim



Figura 2.10: Fotografimi i udhëkryqit përgjatë rrugës “Vëllezërit Frashëri” në drejtim të kycjes me rrugën “Hasan Prishtina”



Figura 2.11: Fotografimi i udhëkryqit përgjatë rrugës “Hasan Prishtina” në drejtimin Perëndim-Lindje

2.3. Kryqëzimi i formës “T” i rrugës “Hasan Prishtina” dhe “Ferid Curri” (Nr. 3)

Udhëkryqi ndodhet afër pompës së benzinës IP Petrol. Bazuar nga matjet në terren themi se kemi një ngarkesë të madhe me të gjitha kategoritë e pjesëmarrësve. Kjo ndodh për arsye se udhëkryqi gjendet në qendër të qytetit dhe njashtu lidhet me një pjesë të fshatit Mazgit dhe Llazarevë. Në këto kryqëzime që gjendet në qendër të qytetit duhet të theksohet edhe numri i madh i këmbësorëve dhe çiklistëve që frekuentojnë e sidomos gjatë mesit të ditës si dhe numri më i madh është gjatë ditës së premtë në mesditë gjatë kohës së faljes së Xhumasë.

Gjendja infrastrukturore dhe e sinjalizimit horizontal dhe vertikal janë paraqitur në Figurat 2.12, 2.13, 2.14, 2.15 dhe 2.16 ku shihen pozicioni i udhëkryqit, shtrirja e tij dhe fotografimi i udhëkryqit në tri degët e tij të bëra në terren.




Figura 2.12: Vendndodhja e udhëkryqit “3” në plan shtrirje i paraqitur përmes shenjës “●”



Figura 2.13: Gjendja ekzistuese e udhëkryqit “3”



Figura 2.14: Fotografimi i udhëkryqit përgjatë rrugës “Hasan Prishtina” në drejtimin Lindje-Perëndim



Figura 2.15: Fotografimi i udhëkryqit përgjatë rrugës “Hasan Prishtina” në drejtimin Perëndim-Lindje



Figura 2.16: Fotografimi i udhëkryqit përgjatë rrugës “Ferid Curri” në drejtim të kyçjes me rrugën “Hasan Prishtina”

2.4. Kryqëzimi i formës “T” i rrugës “Hasan Prishtina” dhe “Durrësi” (Nr. 4)

Udhëkryqi ndodhet te sheshi “Aziz Zhilivoda. Bazuar nga matjet në terren themi se kemi një ngarkesë mesatare të gjitha kategoritë e pjesëmarrësve në komunikacion. Kjo ndodh për arsye se udhëkryqi gjendet në qendër të qytetit dhe njashtu lidhet me disa zona që janë më së shumti të banuara dhe ku zhvillohet puna më shumë pasi që gjatë numërimit në terren u vërejtën shumë komba të firmave që frekuentonin atë segment.

Gjendja infrastrukturore dhe e sinjalizimit horizontal dhe vertikal janë paraqitur në Figurat 2.17, 2.18, 2.19, 2.20 dhe 2.21 ku shihen pozicioni i udhëkryqit, shtrirja e tij dhe fotografimi i udhëkryqit në tri degët e tij të bëra në terren.




Figura 2.17: Vendndodhja e udhëkryqit “4” në plan shtrirje i paraqitur përmes shenjës “●”



Figura 2.18: Gjendja ekzistuese e udhëkryqit “4”



Figura 2.19: Fotografimi i udhëkryqit përgjatë rrugës “Hasan Prishtina” në drejtimin Lindje-Perëndim



Figura 2.20: Fotografimi i udhëkryqit përgjatë rrugës “Durrësi” në drejtim të kycjes me rrugën “Hasan Prishtina”



Figura 2.21: Fotografimi i udhëkryqit përgjatë rrugës “Hasan Prishtina” në drejtimin Perëndim-Lindje

2.5. Kryqëzimi i formës “T” i rrugës “Vashingtoni” dhe “Hasan Prishtina” (Nr. 5)

Udhëkryqi ndodhet në pjesën e pazarit dhe rruga dytësore gjendet në mes të oborrit të kishës dhe xhamisë së qytetit. Bazuar nga matjet në terren themi se kemi një ngarkesë të madhe me të gjitha kategoritë e pjesëmarrësve. Kjo ndodh për arsye se udhëkryqi gjendet në qendër të qytetit dhe se është kryqëzimi më i afërt që lidh qendrën e Obiliqit me fshatrave të Obiliqit që janë: Milloshevë, Babimoc, Bakshi, Plemetin dhe një pjesë të Hamidisë si dhe qytetin e Vushtrrisë, Mitrovicës, Podujevës dhe një pjesë të Prishtinës.

Gjendja infrastrukturore dhe e sinjalizimit horizontal dhe vertikal janë paraqitur në Figurat 2.22, 2.23, 2.24, 2.25 dhe 2.26 ku shihen pozicioni i udhëkryqit, shtrirja e tij dhe fotografimi i udhëkryqit në tri degët e tij të bëra në terren.



Figura 2.22: Vendndodhja e udhëkryqit “5” në plan shtrirje i paraqitur përmes shenjës “●”



Figura 2.23: Gjendja ekzistuese e udhëkryqit “5”



Figura 2.24: Fotografimi i udhëkryqit përgjatë rrugës “Vashingtoni” në drejtim të kycjes me rrugën “Hasan Prishtina”



Figura 2.25: Fotografimi i udhëkryqit përgjatë rrugës “Hasan Prishtina” në drejtimin Perëndim-Lindje



Figura 2.26: Fotografimi i udhëkryqit përgjatë rrugës “Hasan Prishtina” në drejtimin Lindje-Perëndim

2.6. Rrethrotullimi tre degësh që lidh rrugët “Vicianum”, “Isa Boletini” dhe “Dëshmorët e Kombit” (Nr. 6)

Rrethrotullimi ndodhet në pjesën fillestare për kyçje në qendër të Obiliqit. Bazuar nga matjet në terren themi se kemi një ngarkesë të madhe me të gjitha kategoritë e pjesëmarrësve. Kjo ndodh për arsye se udhëkryqi gjendet në fillim të qytetit dhe se është kryqëzimi më i afërt që lidh qendrën e Obiliqit me fshatrave të Obiliqit që janë: Milloshevë, Babimoc, Bakshi, Plemetin dhe një pjesë të Hamidisë si dhe qytetin e Vushtrrisë, Mitrovicës, Podujevës dhe një pjesë të Prishtinës.

Gjendja infrastrukturore dhe e sinjalizimit horizontal dhe vertikal janë paraqitur në Figurat 2.27, 2.28, 2.29, 2.30 dhe 2.31 ku shihen pozicioni i udhëkryqit, shtrirja e tij dhe fotografimi i udhëkryqit në tri degët e tij të bëra në terren.



Figura 2.27: Vendndodhja e udhëkryqit “6” në plan shtrirje i paraqitur përmes shenjës “●”



Figura 2.28: Gjendja ekzistuese e udhëkryqit “6”



Figura 2.29: Fotografimi i udhëkryqit përgjatë rrugës “Vicianum”



Figura 2.30: Fotografimi i udhëkryqit përgjatë rrugës “Dëshmorët e Kombit”



Figura 2.31: Fotografimi i udhëkryqit përgjatë rrugës “Isa Boletini”

2.7. Kryqëzimi i formës “T” të rrugës “Washingtoni” dhe “Ukshin Hoti” (Nr. 7)

Kryqëzimi ndodhet në pjesën fillestare për kyçje në qendër të Obiliqit. Bazuar nga matjet në terren themi se kemi një ngarkesë të madhe me të gjitha kategoritë e pjesëmarrësve. Kjo ndodh për arsye se udhëkryqi gjendet në fillim të qytetit dhe se është kryqëzimi më i afërt që lidh qendrën e Obiliqit me fshatrave të Obiliqit që janë: Milloshevë, Babimoc, Bakshi, Plemetin dhe një pjesë të Hamidisë si dhe qytetin e Vushtrisë, Mitrovicës, Podujevës dhe një pjesë të Prishtinës.

Gjendja infrastrukturore dhe e sinjalizimit horizontal dhe vertikal janë paraqitur në Figurat 2.32, 2.33, 2.34 dhe 2.35 ku shihen pozicioni i udhëkryqit, shtrirja e tij dhe fotografimi i udhëkryqit në tri degët e tij të bëra në terren.



Figura 2.32: Vendndodhja e udhëkryqit “7” në plan shtrirje i paraqitur përmes shenjës “●”



Figura 2.33: Fotografimi i udhëkryqit përgjatë rrugës “Ukshin Hoti” në drejtimin Jug-Veri



Figura 2.34: Fotografimi i udhëkryqit përgjatë rrugës “Vashingtoni” në drejtim të kyçjes me rrugën “Ukshin Hoti”



Figura 2.35: Fotografimi i udhëkryqit përgjatë rrugës “Ukshin Hoti” në drejtimin Veri-Jug

2.8. Kryqëzimi i formës “+” të rrugëve “Ukshin Hoti”, “Vëllezërit Frashëri” dhe “Abdurrahmon Gërguri” (Nr. 8)

Udhëkryqi ndodhet afër hekurudhës. Bazuar nga matjet në terren vërejmë se kemi një ngarkesë të madhe me të gjitha kategoritë e pjesëmarrësve. Kjo ndodh për arsye se udhëkryqi gjendet në pjesën e lidhjes së qendrës së qytetit me fshatrat të cilat janë: Caravodica, Leshkoshiqi, Hadeja, Shipitulla, Siboci, një pjesë e Hamidisë dhe Grabocit, si dhe mund të lidhet edhe me disa fshatra të Fushë Kosovës.

Gjendja infrastrukturore dhe e sinjalizimit horizontal dhe vertikal janë paraqitur në Figurat 2.36, 2.37, 2.38, 2.39 dhe 2.40 ku shihen pozicioni i udhëkryqit, shtrirja e tij dhe fotografimi i udhëkryqit në tri degët e tij të bëra në terren.




Figura 2.36: Vendndodhja e udhëkryqit “8” në plan shtrirje i paraqitur përmes shenjës “●”



Figura 2.37: Fotografimi i udhëkryqit përgjatë rrugës “Ukshin Hoti” në drejtimin Jug-Veri



Figura 2.38: Fotografimi i udhëkryqit përgjatë rrugës “Ukshin Hoti” në drejtimin Veri-Jug




Figura 2.39: Fotografimi i udhëkryqit përgjatë rrugës “Vëllezërit Frashëri” në drejtim të kyçjes me rrugën “Ukshin Hoti”



Figura 2.40: Fotografimi i udhëkryqit përgjatë rrugës “Abdurrahmon Gërguri” në drejtim të kyçjes me rrugën “Ukshin Hoti”

2.9. Kryqëzimi i formës “T” të rrugës “Ukshin Hoti” dhe “Vëllezërit Gërvalla”(Nr. 9)

Udhëkryqi ndodhet afër dyqanit Emona Center. Bazuar nga matjet në terren vërejmë se nuk kemi ndonjë ngarkesë të madhe të pjesëmarrësve. Kjo ndodh për arsye se udhëkryqi gjendet në pjesën ku automjetet nuk e synojnë qendrën e qytetit po pjesët periferike ose Prishtinën apo Fushë Kosovën.

Gjendja infrastrukturore dhe e sinjalizimit horizontal dhe vertikal janë paraqitur në Figurat 2.41, 2.42, 2.43, 2.44 dhe 2.45 ku shihen pozicioni i udhëkryqit, shtrirja e tij dhe fotografimi i udhëkryqit në tri degët e tij të bëra në terren.



Figura 2.41: Pozicioni i udhëkryqit “9” i paraqitur përmes shenjës “●”



Figura 2.42: Gjendja ekzistuese e udhëkryqit “9”



Figura 2.43: Fotografimi i udhëkryqit përgjatë rrugës “Ukshin Hoti” në drejtim të kyçjes me rrugën “Vëllezërit Gërvalla”



Figura 2.44: Fotografimi i udhëkryqit përgjatë rrugës “Vëllezërit Gërvalla” në drejtimin Veri-Jug



Figura 2.45: Fotografimi i udhëkryqit përgjatë rrugës “Vëllezërit Gërvalla” në drejtimin Jug-Veri

3. GJENDJA AKTUALE E SINJALIZIMIT NË SEGMENTET E DHËNA

Me ndihmën e sinjalizimit, pjesëmarrësit në trafik lajmërohen për gjendjen e komunikacionit, duke arritur në këtë mënyrë, qarkullim të sigurt dhe pa pengesa. Pra, sinjalizimi në trafik është me rëndësi të veçantë për secilin pjesëmarrës në të. Në Figurën 3.1 është paraqitur ndarja e sinjalizimit.

Zhvillimi i hovshëm i komunikacionit në ditët e sotme, kërkon njohjen e planeve të sinjalizimit në trafik dhe në përgjithësi, rregullimin dhe projektimin në trafik, gjë që deri më tani nuk është kujdes i mjaftueshëm.

Sinjalizimi në trafik duhet të jetë i thjeshtë, i qartë, i dukshëm, universal, me dizajn përkatës dhe vendosur në interval të caktuar [2, 3].




Figura 3.1: Ndarja e sinjalizimit [2]

3.1. Sinjalizimi vertikal

Në grupin e sinjalizimit vertikal bëjnë pjesë këto shenja:

- Shenjat e rrezikut,
- Shenjat e urdhrave të prera,
- Shenjat e lajmërimit (treguese), dhe
- Shenjat për shënimet e ndryshme plotësuese (Tabela plotësuese) [2].

Vetitë e përgjithshme të sinjalizimit vertikal, janë:

- Gjatë vendosjes së sinjalizimit vertikal, duhet pasur kujdes që të mos vendosen numër i madh i shenjave, ngaqë do të sjellë habi te ngasësi, pra, duhet vendosur vetëm numër të nevojshëm të shenjave përkatëse,
- Shenjat në trafik duhet të jenë uniforme (përpikëria në shprehje të situatës, intensitetit, formës, ngjyrës, mbishkrimit etj.),

- Paraqitja e qartë e shenjës (gjë që vret nga madhësia, numri dhe gjatësia e mbishkrimit si dhe nga forma e shkronjave dhe simboleve etj.) dhe
- Dukshmëria e shenjave (e cila varet nga madhësia e shenjës dhe vendi i vendosjes etj.) [2].

3.2. Shtylla dhe vendosja e shenjës së komunikacionit

Shtylla e shenjës së komunikacionit më së shpeshti paraqet shtyllën e cila mundëson që shenja e komunikacionit të vihet në sipërfaqen vertikale. Në parim mund të jetë në forma dhe pamje të ndryshme, nuk janë të unifikuara por zakonisht janë të definuar në disa forma, të cilat përdoren për vënien e shenjës së komunikacionit.

Shtylla e shenjës së komunikacionit ngjashëm me të gjithë mbajtësit tjerë dimensionohet në raport me peshën e shenjës së komunikacionit, mënyrës së varjes dhe vendit të vendosjes së shenjës. Kjo e fundit është shumë e rëndësishme dhe duhet patjetër të kemi kujdes për fortësinë e erës në vendin ku vihet shenja. Kur bëhet fjalë për shtyllat e shenjave të komunikacionit duhet të jenë sipas standardit, në Figurat 3.2, 3.3, 3.4, 3.5, 3.6 dhe 3.7 do të shihen standardet e vendosjes së shenjave të komunikacionit si dhe montimi i tyre [4, 5].





Figura 3.2: Dimensionet e shtyllave pjesës së fundmit dhe shenjave [4, 6]




Figura 3.3: Montimi i shenjave me mbajtës të shtrënguar me bulona[4]

Detali i vendosjes



Përbërja e shenjës



"fytyra e shenjës"

Detali i fundimit




Figura 3.4: Detali i vendosjes, përbërja e shenjës dhe "fytyra" e saj [4, 7]



Mbajtësit e shenjës në shtylla

Figura 3.5: Mbajtësit e shenjave në shtyllë [4]




Figura 3.6: Mbajtësit e shtyllave për tabela të profilit alumini dhe profileve të galvanizuara[4]




Figura 3.7: Metodat e vendosjes së shtyllave[4].

3.3. Sinjalizimi horizontal

Në sinjalizimin horizontal bëjnë pjesë shenjat, të cilat vendosen në vetë sipërfaqen e rrugës, dhe gjejnë zbatimin sidomos në akset më bashkëkohore të trafikut. Këto mundësojnë zhvillimin më të lehtë të trafikut, ndërsa si mangësi e tyre, konsiderohet fakti se, pas të reshurave të borës, humbin nga qartësia, andaj duhet të përsëriten shpesh.

Shenjat horizontale në sipërfaqen e rrugës, rëndom janë të ngjyrës së bardhë (me ngjyrë të verdhë shënohen vendet, në të cilat është e ndaluar parkimi).

Shenjat horizontale në sipërfaqen e rrugës mund të ndahen në:

- Shenja gjatësore,
- Shenja tërthore, dhe
- Shenja tjera në sipërfaqen e rrugës [8, 6].

3.4. Shenjat gjatësore

Shenjat gjatësore mund të jenë:

- Vijat e plota,
- Vijat e ndërprera, dhe
- Vijat e dyfishta [8].

3.5. Vijat e plota

Gjerësia e tyre varet nga kategoria e rrugës në të cilën shënohen, respektivisht nga gjerësia e shiritave të komunikacionit, në rrugët në vendbanime. Dimensionet e vijave të plota janë paraqitur në Tabelën 3.1 [8].

Tabela 3.1: Dimensionet e vijave të plota [8]

Gjerësia e vijës	Kategoria e rrugës
0.10 m	në rrugët lokale
0.12 m	në rrugët regjionale
0.15 m	në rrugët magjistrale
0.15 ose 0.20 m	në rrugë të rezervuara për komunikacion të automjeteve ose autoudha
Gjerësia e vijës	Kategoria e rrugës në vendbanime
0.10 m	në rrugët me shirit të komunikacionit të gjerësisë deri në 2.5 m
0.12 m	në rrugët me shirit të komunikacionit të gjerësisë prej 2.5 – 3.0 m
0.15 m	në rrugët me shirit të komunikacionit të gjerësisë prej 3.0 – 3.75 m

3.6. Shenjat tjera në sipërfaqen e rrugës

Shenjat tjera në sipërfaqen e rrugës janë shigjetat, mbishkrimet, shenjat pranë aksit rrugor etj. Në akset rrugore me shumë shirita qarkullimi, shënohen shigjetat para kryqëzimeve, të cilat paralajmërojnë rrugëtimin në të djathtë, drejt dhe në të majtë të cilat janë të paraqitura në Figurën 3.8 [9, 10].




Figura 3.8: Dimensionet e shenjave horizontale[9]

3.7. Sinjalizimi ndriçues

Sinjalizimi ndriçues për rregullimin e komunikacionit mund edhe të futet në sinjalizimin vertikal, por vet fakti që ai aplikohet gjithnjë vetëm nëpër udhëkryqe e bën atë si temë e trajtimit të veçantë të një tipi të sinjalizimit të komunikacionit [8, 11].

Në sinjalet ndriçuese bëjnë pjesë:

- shenjat ndriçuese për rregullimin e trafikut të automjeteve,
- shenjat ndriçuese për rregullimin e qarkullimit të këmbësorëve,
- shenjat ndriçuese për rregullimin e qarkullimit të tramvajeve,
- shenjat për informim të kalimit nëpër binar hekurudhor dhe
- shenjat për paralajmërim të punëve nëpër aksin rrugor etj [8].

Shenjat ndriçuese (semaforët) që shërbejnë për rregullimin e trafikut të automjeteve janë pajisje me drita trengjyreshe (e kuqe, e verdh, e gjelbër), ku këto drita zakonisht vendosen sipas aksit vertikal njëra pas tjetrës në Figurat 3.9, 3.10 dhe 3.11 janë paraqitur format dhe vendosja e semaforit [8, 12].



Figura 3.9: Semafori [8]

Ngjyra e gjelbër mund të ketë edhe shenja plotësuese në forme të shigjetës e cila është vendosur në rreth me ngjyrë të zezë [8].




Figura 3.10: Semafori me shigjeta për lejim qarkullimi [8]




Figura 3.11: Pozicioni i vendosjes së shenjave dhe semaforëve [8]

Shenja vertikale duhet që gjithmonë të vendoset në krahun e djathtë të ngasësit. Këtu ekzistojnë edhe përjashtime kur shenjat vendosen edhe në anën e majtë të rrugët shumëshiritore vendosen edhe në portal.

- Në raste të veçanta shenja vendoset vetëm në anën e majtë, por këtë duhet të përdoret vetëm për raste të veçanta dhe për shenja të caktuara dhe
- Përjashtimisht nga ky rregull bënë shenja II-45 (drejtim i detyrueshëm në anën e djathtë), e cila vendoset në ishullin ndarës në anën e majtë shikuar nga drejtimi i qarkullimit[2, 5].

3.8. Gjendja aktuale e sinjalizimit horizontal dhe vertikal në Obiliq

Sinjalizimi horizontal dhe vertikal në komunën e Obiliqit nuk është e përmasave të lavdëruara po edhe njashtu nuk është e përmasave të mjeruara, arsyeja është se ka në disa kryqëzime që mungon sinjalizimi, kyçjet në rrugën kryesore nuk paralajmërohen fare, gjendja e vendkalimit të këmbësorëve në disa vende vetëm sa nuk është shlyer dhe kjo arsyeton faktin që kërkohet një investim në fushën e sinjalizimit.

Gjatë inspektimit në terren janë bërë disa foto të gjendjes aktuale të cilat janë paraqitur në Figurat 3.12, 3.13 dhe 3.14



Figura 3.12: Afërsia e zhdukjes së gjurmëve dhe gjendja e vendkalimit të këmbësorëve



Figura 3.13: Shtirirja e vendkalimit të këmbësorëve në rrugën “Washingtoni”



Figura 3.14: Sinjalizimi horizontal në komunën e Obiliqit

4. ANALIZAT DHE PROPOZIMET PËR PËRMIRËSIM E GJENDJES SE TRAFIKUT

Përveç pjesëmarrësve në trafik, dhe gjeometrisë së rrugëve, trafiku ka karakteristikat tjera kryesore që janë të nevojshme për llogaritje, analiza dhe rezultate.

Këto karakteristika janë:

- Vëllimi,
- Kërkesa,
- Shkalla e qarkullimit,
- Kapaciteti dhe
- Niveli i shërbimit.

Ndonjëherë këta parametra përdoren në relacion me parametrat tjera apo konditat tjera. Këta katër parametra janë të ndërlidhur dhe të gjithë janë të shprehur me njësi të njëjta apo të ngjashme.

Matja e këtyre parametrave veçmas varet nga automjetet në lokacionet e studiuara të trafikut, që mund të jenë rrugë urbane, autostradë, rrugë rurale, kryqëzime, rrethrotullim, etj. Nëse automjetet janë numëruar në çfarëdo lokacioni të definuar për një orë, atëherë:

- **Vëllimi** do të jetë numri i automjeteve të numëruara që kalojnë lokacionin që studiohet për një orë (aut/h).
- **Kërkesa** – do të jetë vëllimi plus automjetet që kërkojnë të kalojnë pjesën e rrugës që studiohet për një orë, dhe të cilët janë mohuar ta bëjnë këtë për shkak të tollovisë. Më vonë mund të përfshijë motoristët në rend të pritjes të cilët presin të arrijnë lokacionin e studiuar, shoferët dhe motoristët që përdorin marshuta alternative për të evituar tollovitë rreth lokacionit të studiuar, dhe shoferët që vendosin mos me udhëtua për shkak të tollovisë së madhe.
- **Shkalla e qarkullimit** - Paraqet shkallën në të cilën automjetet (ose personat) kalojnë në pikën e shikuar gjatë një periudhe të caktuar kohore për më pak se një orë, të shprehur si një ekuivalent i shkallës në orë.
- **Kapaciteti** – paraqet shkallën maksimale në të cilën automjetet mund të kalojnë një pikë apo një segment të shkurtë gjatë një periudhe të caktuar kohore. Paraqet karakteristikën e rrugës së automjeteve. Vëllimi aktual kurrë nuk mund të evidentohet në nivelet më të larta se kapaciteti i vërtetë i seksionit. Por, rezultatet e tilla mund të paraqiten për shkak se kapaciteti shpesh është parashikuar duke përdorur procedura standarde të analizave. Këto parashikime mund të ndodh që të jenë shumë të ulëta për disa lokacione.
- **Niveli i shërbimit** – Paraqet parametrin kualitativ që përdoret për të definuar kualitetin e shërbimeve të trafikut[13].

4.1. Niveli i shërbimit

Niveli i shërbimit përdoret për të analizuar trafikun duke e kategorizuar qarkullimin e trafikut dhe duke caktuar nivelet e kualitetit për performancën e trafikut bazuar në matjet e performancës, si matjet e shpejtësisë, densiteti, pastaj lirinë e lëvizjes, pengesat e trafikut, komfortin, dhe lehtësinë e manovrimit në trafik, etj. Për këtë qëllim janë definuar 6 nivele të shërbimit (LOS – Level of service) për secilën komponentë të trafikut në të cilën mund të realizohen analizat.

A – qarkullim i lirë. Qarkullimi i trafikut në kufirin e shpejtësisë së deklaruar i mundëson shoferëve një mobilitet komplet në rrugë dhe në mes të korsive. Hapësira mesatare në mes të automjeteve është rreth 167 m ose 27 gjatësi të automjeteve. Shoferët dhe motoristët kanë një nivel të lartë të komfortit fizik dhe psikologjik. Efektet e aksidenteve ose bllokimet me lehtësi absorbohen. NSH A zakonisht ndodh në mbrëmje vonë në hapësirat urbane dhe shumë më shpesh në hapësirat rurale.

B – qarkullim relativisht i lirë. Shpejtësitë janë të njëjta si në NSH A, manovrueshmëria në rrjedhën e trafikut është pak e kufizuar. Hapësira minimale mesatare në mes të automjeteve është rreth 110 m, ose 16 gjatësi të automjeteve. Shoferët dhe motoristët ende janë një nivel të lartë të komfortit fizik dhe psikologjik.

C – qarkullim stabil. Aftësia për të manovruar nëpër korsitë është dukshëm e kufizuar dhe ndryshimi i korsive kërkon një kujdes më të madh të shoferëve. Hapësira minimale në mes të automjeteve është rreth 67 m, ose 11 gjatësia të automjeteve. Shumica e shoferëve me përvojë të madhe janë mjaft komfor, rrugët janë ende të sigurta nën kapacitetin apo afër kapacitetit, ndërsa kufizimi i shpejtësisë mbahet. Aksidentet e vogla ende mund të kenë efekt, pasi mund të krijohen rende pas aksidentit. Niveli C është qëllim i shumicës së hapësirave urbane.

D – Afërsisht një qarkullim jostabil. Shpejtësitë ulen derisa vëllimi i trafikut rritet. Liria e manovrimit në trafik është shumë më e limituar dhe komforti i shoferit bie. Automjetet kanë hapësirë së paku 50 m, ose 8 gjatësia të automjeteve. Incidentet e vogla të trafikut do të krijojnë vonesa. Rrugët urbane kanë qëllim të arrijnë këtë nivel gjatë orëve të pikut, pasi Niveli C vlerësohet i vështirë për tu arritur.

E – Qarkullim jostabil, operimi në kufi të kapacitetit. Qarkullimi bëhet jo i rregullt dhe shpejtësitë varojnë ndjeshëm për shkak se nuk ka hapësirë për manovrim në trafik, dhe shpejtësitë rrallë arrijnë kufirin e deklaruar. Hapësira në mes të automjeteve është rreth 2 gjatësi. Çdo çrregullim në trafik do të krijojë një valë shoku që do të ndikojë në tërë rrjedhën e trafikut. Çfarëdo incidenti do të krijojë vonesa serioze.

F – Qarkullim i sforcuar ose i dështuar. Secili automjet lëviz në rend me automjet para tij, ku kërkohet ngadalësim i shpeshtë. Koha e lëvizjes nuk mund të parashikohet, por ka më shumë kërkesë se kapacitet. Një rrugë me tollovi konstante trafiku bën pjesë në këtë nivel. Shumica e rrugëve të ngarkuara urbane janë në këtë nivel, por jo në gjendje të përhershme dhe konstante.

Vlerat e niveleve të shërbimit janë të paraqitura në Tabelën 4.1 për kryqëzime me sinjalizim dhe pa sinjalizim.

Tabela 4.1: Niveli i shërbimit për kryqëzimet me sinjalizim dhe pa sinjalizim

NSH (Niveli i shërbimit)	Kryqëzim i sinjalizuar	Kryqëzim i pa sinjalizuar
A	≤ 10 s	≤ 10 s
B	10–20 s	10–15 s
C	20–35 s	15–25 s
D	35–55 s	25–35 s
E	55–80 s	35–50 s
F	≥ 80 s	≥ 50 s

Niveli i shërbimit mund të kalkulohet për lëvizje, pse për afrim në çfarëdo konfigurimi të kryqëzimit, por niveli i shërbimit për kryqëzimi si tërësi është definuar vetëm për kryqëzimet e sinjalizuara dhe konfigurimet me shenjën e ndalimit – STOP. Nivelet dhe vonesat janë treguar në Tabelën 4.3.

Hyrja në rrethrotullim është gjithmonë e kontrolluar me shenjë. Niveli i shërbimit mund të aplikohet edhe për komponentët tjera të trafikut që janë:

- Rrugët me dy korsi, (qarkullim i pandërprerë),
- Rrugët me shumë korsi (4 apo më shumë) , (qarkullim i pandërprerë),
- Hyrjet ne autostradë, rrugët përmbledhëse, daljet, dhe korsitë me disnivel,
- Hapësirat për çiklistë (matjet e efektivitetit, ngjarjet për orë, ngjarjet e takimit të automjetit me çiklistët në një drejtim, takim nga drejtimi i kundërt, apo që kalojnë korsitë) dhe
- Hapësirat e kalimtarëve (matjet e efektivitetit – kalimtarët për njësi të sipërfaqes) [6, 12].

Në Tabelën 4.2 është paraqitur tabela e krahasimit në mes të nivelit të shërbimit dhe shkallës V/C ndërsa në Tabelën 4.3 është niveli i shërbimit në bazë të hapësirës së pritjes për person.

Tabela 4.2: Raporti V/C

Niveli i shërbimit	Raporti V/C
A	0.0-0.35
B	0.35-0.58
C	0.58-0.75
D	0.75-0.90
E	0.90-1.00
F	>1.00

Tabela 4.3: Hapësirat për lëvizje dhe pritje për person

NSH (Niveli i shërbimit)	Hapësira e lëvizjes (për person)	Hapësira e pritjes (për person)
A	$>3.3 \text{ m}^2$	$>1.2 \text{ m}^2$
B	$2.3 \text{ m}^2 - 3.3 \text{ m}^2$	$0.92 \text{ m}^2 - 1.2 \text{ m}^2$
C	$1.4 \text{ m}^2 - 2.3 \text{ m}^2$	$0.65 \text{ m}^2 - 0.92 \text{ m}^2$
D	$0.93 \text{ m}^2 - 1.4 \text{ m}^2$	$0.27 \text{ m}^2 - 0.65 \text{ m}^2$
E	$0.46 \text{ m}^2 - 0.93 \text{ m}^2$	$0.18 \text{ m}^2 - 0.27 \text{ m}^2$

4.2. Përcaktimi i vonesave

Llogaritja e nivelit të shërbimit në rrugë urbane ose seksion kërkon llogaritjen e vonesave të kontrolluara. Vonesa e kontrolluar për lëvizjen drejt është vonesë e përshtatshme për ta përdorur në evoluim të rrugëve urbane. Në ekuacionet më poshtë është treguar mënyra e llogaritjes së vonesave:

$$d = d_1 \cdot (FP) + d_2 + d_3 \quad (4.5)$$

$$d_1 = \frac{0.5 \cdot C \cdot \left(1 - \frac{g}{C}\right)^2}{1 - \left[\min(1, X) \cdot \frac{g}{C}\right]} \quad (4.6)$$

$$d_2 = 900 \cdot T \cdot \left[(X - 1) + \sqrt{(X - 1)^2 + \frac{8 \cdot k \cdot I \cdot X}{c \cdot T}} \right] \quad (4.7)$$

Ku janë shënuar me:

d – vonesa e kontrolluar (s/aut),

d_T – vonesa uniforme (s/aut),

d_2 – vonesa inkrementale (s/aut),

d_3 – vonesa initiale e rendit të automjeteve (s/aut),

FP – faktori i rregullimit të progresionit të togut të automjeteve,

X – shkalla v/c për grupin e korsive (definicion edhe për Shkallën e Ngopjes),

C – gjatësia e ciklit (s),

c – kapaciteti i grupit të korsive (aut/h),

g – koha efektive e gjelbër për grupin e korsive (s),

T – kohëzgjatja e periudhës së analizës (h),

k – rregullimi i vonesës inkrementale për kontrollin e përshtatur dhe

I – rregullimi i vonesës inkrementale për filtrimin apo matjen e sinjaleve të fluksit të lëvizjes përpara [13].

4.3. Llogaritja e d_3 - vonesa initiale e rendit të automjeteve (s/aut)

Forma e përgjithshme e llogaritjes së parametrin d_3 është paraqitur në ekuacionin (4.8). Kjo ofron përafrim të vonesave fillestare të automjeteve në rend (në sekonda) ku rendi fillestar me numër të automjeteve R_b ekziston në fillim të periudhës së analizës T :

$$d_3 = \frac{1800 \cdot R_b \cdot (1 + u) \cdot t}{c \cdot T} \quad (4.8)$$

Ku janë shënuar me:

- R_b – Rendi fillestar në fillim të periudhës së matjes T (aut),
- c – kapaciteti i grupit të korsive (aut/h),
- T – kohëzgjatja e periudhës së analizës (h),
- t – kohëzgjatja e kërkesës së pa ofruar në T (h) dhe
- u – parametri i vonesës.

Kontrolli i përshtatur - (ang. *Actuated control*), do të thotë sinjalizimi me semafor i përshtatur në bazë të automjeteve apo kalimtarëve që i afrohen nyjës apo udhëkryqit. Semafori aktivizohet vetëm kur ka automjeteve prezentë, ndërsa kur nuk ka automjete për shërbim, atëherë rregullon në mënyrë automatike fazat e sinjalizimit për drejtimet tjera. Realizohet me anë të sensorëve dhe detektorëve të lidhur direkt me sistemin e sinjalizimit. Sinjalizim i dirigjuar.

Vonesa uniforme - Ekuacioni (4.6) jep llogaritjen e vonesës së kontrolluar duke supozuar se kemi arritje uniforme perfektë dhe qarkullim stabil. Është një përshkrim i përshtatshëm i vonesës për rastin e arritjeve uniforme. Vlerat e X (v/c) më të mëdha se 1.0 nuk përdoren për llogaritjen e d_1 .

Vonesa inkrementale - Ekuacioni (4.7) jep llogaritjen e vonesës inkrementale për shkak të arritjeve jouniforme dhe dështimet e cikleve individuale (p.sh. vonesat e rastit), si dhe vonesat e shkaktuara nga periudhat e shpeshta të mbingopjes (p.sh. vonesat e mbingopjes). Ekuacioni paraqet ndërlidhjen me shkallën e ngopjes (X) për grupin e korsive, kohëzgjatjen e analizës (T), kapacitetin e grupit të korsisë (c), dhe kontrollin e sinjalit (k). Ekuacioni supozon se i tërë qarkullimi në bazë të kërkesës i është ofruar shërbimi në analizën e mëhershme – do të thotë nuk ka rende initiale. Vonesa inkrementale vlen për të gjitha shkallët e ngopjes së trafikut.

Vonesat initiale të rendeve - Kur rendet nga periudha e kaluar është prezent në fillim të analizave, automjetet e reja që arrijnë krijojnë vonesa initiale të rendeve. Këto vonesa rezultojnë prej kohës shtesë që kërkohet për të zbrazur endin inicial. Madhësia e tyre varet nga gjatësia e rendit inicial, gjatësia e periudhës së analizës, dhe shkalla v/c për atë periudhë.

Rregullimi i vonesës inkrementale për kontrollin e përshtatur – Paraqitet me faktorin k , do të thotë efekti i kontrollorëve të sinjalizimit në vonesat inkrementale. Për sinjale të rregulluara me semafor, dhe pa rregullim me sendorë apo dirigjim merret zakonisht $k = 0.50$.

Rregullimi i vonesës inkrementale për filtrimin apo matjen e sinjaleve të fluksit të lëvizjes përpara – Matet me parametrin I , dhe paraqet vlerën e bazuar në numrin e çfarëdoshëm apo të rastit të automjeteve që arrijnë për një cikël ashtu që variabiliteti i arritjeve është i barabartë me mesataren e arritjeve. Vlera e I për një udhëkryq të izoluar është $I = 1.0$, që do të thotë për udhëkryqe në distancë më të madhe se 1.6 km nga nyja apo udhëkryqi tjetër. Vlerat $I < 1.0$ vlejnë për udhëkryqe jo të izoluar në rrugë. Nga Tabela 4.4, vlera X_u paraqet shkallën e v/c për të gjitha lëvizjet në një drejtim dhe drejt të cilat kontribuojnë në vëllimin e grupit të korsive në studim [13].

Tabela 4.4: Parametri i rregullimit të vonësës inkrementale për filtrimin apo matjen e sinjaleve të fluksit të lëvizjes përpara

	Shkalla e ngopjes për udhëkryqin gjatë lëvizjes përpara drejt X_u						
	0.40	0.50	0.60	0.70	0.80	0.90	≥ 1.0
Vlera e I	0.922	0.858	0.769	0.650	0.500	0.314	0.090

4.4. Faktori i rregullimit të progresionit të togut te automjeteve

Një sinjal dobët i rregulluar rezulton me arritjen e numri të vogël të automjeteve në të gjelbër. Faktori i rregullimit të progresionit të automjeteve FP aplikohet në të gjitha grupet e korsive. Progresioni kryesisht ndikon në vonësën uniforme, prandaj aplikohet vetëm në parametrin d_1 . Vlera e faktorit të rregullimit të progresionit (FP) mund të përcaktohet nga ekuacioni :

$$FP = \frac{(1-P) \cdot f_{FPS}}{\left(1 - \frac{g}{C}\right)} \quad (4.11)$$

Ku janë shënuar me:

P – numri i të gjitha automjeteve që arrijnë gjatë të gjelbrës,

g/C – shkalla efektive e të gjelbrës dhe

f_{FPS} – faktori i rregullimit suplementar për arritjen e togut gjatë të gjelbrës.

Vlera e P mund të matet në terren ose të përafrohet nga diagrami kohë-hapësirë. Vlera e FP gjithashtu mund të llogaritet nga vlerat e P duke përdorur vlerat aktuale të f_{FPS} . Në Tabelën 4.5 janë treguar vlerat e faktorit të progresionit – FP në funksion të llojit të arritjes [13, 7].

Tabela 4.5: Vlerat e faktorit të rregullimit të progresionit - FP

Shkalla e të gjelbrës (g/C)	Lloji i arritjes (LA)					
	LA 1	LA 2	LA 3	LA 4	LA 5	LA 6
0.20	1.167	1.007	1.000	1.000	0.833	0.750
0.30	1.286	1.063	1.000	0.986	0.714	0.571
0.40	1.445	1.136	1.000	0.895	0.555	0.333
0.50	1.667	1.240	1.000	0.767	0.333	0.000
0.60	2.001	1.395	1.000	0.576	0.000	0.000
0.70	2.556	1.653	1.000	0.256	0.000	0.000
f_{FPS}	1.00	0.93	1.00	1.15	1.00	1.00
R_p	0.333	0.667	1.000;	1.333	1.667	2.000

Caktimi i shpejtësisë së lëvizjes:

Llogaritja e shpejtësisë mesatare të lëvizjes për secilin segment dhe në tërë seksionin, bazuar në parametrat e vonësës, bëhet me ekuacionin [13, 6].

$$v_{mi} = \frac{3600 \cdot L_i}{(T_{ti} + d_i)} - \text{Shpejtësia për një segment} \quad (4.12)$$

$$v_m = \frac{3600 \cdot \sum L_i}{\sum (T_i + d)_i} - \text{Shpejtësia për të gjitha segmentet (krejt rrugën)} \quad (4.13)$$

Ku janë shënuar me:

v_m – shpejtësia mesatare e lëvizjes drejt të automjeteve në segment (km/h),

L_i – gjatësia e segmentit (m ose km),

T_{ti} – koha e tërë e lëvizjes në segment në seksion të matur (s) dhe

d_i – vonesat e kontrollit për lëvizjes drejt në udhëkryqin e sinjalizuar për segment (s).

4.5. Përcaktimi i shkallës së qarkullimit të ngopur

Shkalla e qarkullimit të ngopur paraqet qarkullimin e automjeteve për orë që mund të akomodohen nga grupi i korsive duke supozuar se faza e gjelbër ofrojnë 100% të kohës së kërkuar ($g/C = 1.0$). Shkalla e qarkullimit të ngopur llogaritet me formulën:

$$q_g = s = q_o \cdot N \cdot f_w \cdot f_{HV} \cdot f_g \cdot f_p \cdot f_{bb} \cdot f_a \cdot f_{LU} \cdot f_{LT} \cdot f_{RT} \cdot f_{Lpb} \cdot f_{Rpb} \quad (4.14)$$

Ku janë shënuar me:

q_g – shkalla e qarkullimit të ngopur për grupin e korsive e shprehur si totali për të gjitha korsitë në grupin e korsive (aut/h),

q_o - Shkalla bazike e qarkullimit për korsitë (aut/h/korsitë),

N - Numri i korsive në grup,

f_w - Faktori i rregullimit të gjerësisë së korsive; Faktori llogaritet për korsitë standard me gjerësi 3.6 m. Në asnjë mënyrë nuk duhet llogaritur për korsitë më të ngushta se 2.4 m,

f_{HV} - Faktori i rregullimit për automjetet e rënda në qarkullim të trafikut,

f_g - Faktori i rregullimit për pjerrtësinë e afrimit në korsitë,

f_p - Faktori i rregullimit për ekzistencën e korsive së parkimit dhe aktivitetin e parkimit si shtesë në grupin e korsive; Manovrimet e parkimit supozohet se bllokohen trafikun për 18 s. Kufiri praktik është 180 manovrimet/h,

f_{bb} - Faktori i rregullimit për efektin e bllokimit të autobusëve lokal që ndalojnë në hapësirën e udhëkryqit; Aplikohet për ndalimet e autobusëve deri në 75 m nga vija e ndalimit të udhëkryqit dhe për kufizim prej 250 autobusëve/h. Faktori përdoret duke supozuar një kohë mesatare të bllokimeve prej 14.4 s gjatë kohës së gjelbër,

f_a - Faktori i rregullimit për llojin e hapësirës,

f_{LU} - Faktori i rregullimit për shfrytëzimin të korsive; Duhet përdorur vëllimet aktuale të distribuimit të fituara në terren për të llogaritur këtë faktor. Nëse kemi distribuim uniform të trafik në të gjitha korsitë, mund të përdoret vlera $f_{LU} = 1.0$,

f_{LT} - Faktori i rregullimit për korsitë e kthimit në të majtë për grupin e korsive,

f_{RT} - Faktori i rregullimit për korsitë e kthimit në të djathtë për grupin e korsive,

f_{Lpb} - Faktori i rregullimit për kalimtarët në lëvizjet në të majtë dhe

f_{Rpb} - Faktori i rregullimit të kthesave në të djathtë për kalimtarë dhe çikliste.

Tabela 4.6: Formulatat për llogaritjen e faktorëve të qarkullimit të ngopur

Faktori	Formula	Definimi i variablave	Shënime shtesë
Gjerësia e korsisë	$F_w = 1 + \frac{(GJK - 3.6)}{9}$	GJK – Gjerësia e korsive (m)	$GJK \geq 2.4$ m. Nëse $GJK > 4.8$ duhet përfshirë analizën për dy korsitë në një drejtim
Automjete të rënda	$F_{AR} = \frac{100}{100 + \%AR \cdot (E_T - 1)}$	%AR – % e automjeteve të rënda për vëllim të grupit të korsive	Përpjesa në mes të automjeteve të udhëtarëve dhe automjeteve të rënda $E_T = 2.0$ aut/AR
Pjerrtësia	$f_g = 1 - \frac{\%G}{200}$	%G – % e pjerrtësisë në grup të korsive gjatë afrimit	$-6 \leq \%G \leq +10$ Negative është lëvizje poshtë
Parkimi	$f_p = \frac{N - 0.1 - \frac{18 \cdot N_m}{3600}}{N}$	N – numri i korsive N_m – numri i manovrimeve të parkimit në orë	$0 \leq N_m \leq 180$ $f_p \geq 0.050$ $f_p - 1.00$ nëse nuk ka parking
Blokimet e autobusëve	$f_{bb} = \frac{N - \frac{14.4 \cdot N_b}{3600}}{N}$	N – numri i korsive në grup N_b – numri i ndalimeve të autobusëve në orë	$0 \leq N_m \leq 250$ $f_{bb} \geq 0.050$
Lloji i hapësirës	$f_a = 0.900$ – për qendër qyteti (CBD) $f_a = 1.00$ – për të gjitha hapësirat tjera		
Shfrytëzimi i korsive	$f_{LU} = \frac{q_{gp}}{q_{gp1} \cdot N}$	q_{gp} – shkalla e parregulluar e kërkesës së qarkullimit për grupin e korsive, aut/h q_{gp1} – shkalla e parregulluar e kërkesës së qarkullimit për një korsitë në grupin e korsive me vëllimin më të madh, aut/h; N – numri i korsive në grup	
Kthimet në të majtë	Faza e mbrojtur (Protected) Korsitë ekskluzive: $f_{LT} = 0.95$ Korsitë e përbashkëta: $f_{LT} = \frac{1}{1.0 + 0.05 \cdot P_{LT}}$		P_{LT} – përpjesa e kthimeve majtas në grup të korsive

Kthimet në të djathtë	Korsitë ekskluzive: $f_{RT} = 0.85$ Korsitë e përbashkëta: $f_{RT} = 1.0 - 0.15 \cdot P_{RT}$ Korsitë e vetme: $f_{RT} = 1.0 - 0.135 \cdot P_{RT}$	P_{RT} - përpjesa e kthimeve djathtas në grup të korsive	$f_{RT} \geq 0.050$
Blokadat kalimtarë-çiklistë	Rregullimi i kthimeve majtas: $f_{Lpb} = 1.0 - P_{LT} \cdot (1 - A_{pbT}) \cdot (1 - P_{LTA})$ Rregullimi i kthimeve djathtas: $f_{Rpb} = 1.0 - P_{RT} \cdot (1 - A_{pbT}) \cdot (1 - P_{RTA})$	P_{LT} - përpjesa e kthimeve majtas në grup të korsive A_{pbT} - rregullimi i fazës së lejuar P_{LTA} - përpjesa e kthimeve majtas në të gjelbër të mbrojtur në raport me kthimet majtas në total të gjelbër P_{RT} - përpjesa e kthimeve djathtas në grup të korsive P_{RTA} - përpjesa e kthimeve djathtas në të gjelbër të mbrojtur në raport me kthimet djathtas në total të gjelbër	

Bazuar nga Tabela 4.6 në rast se kemi situatë kur ekziston faza e lejuar, atëherë vetëm për fazën e lejuar ose në kombinim me fazën e mbrojtur, tabela të veçanta duhet ofruar [13].

4.6. Niveli i shërbimit për udhëkryq të sinjalizuar

Parametri kryesor i definimit të nivelit të shërbimit (ang. LOS) është vonesa e kontrolluar, që paraqet parametrin e frustrimit dhe komfortit të dobët të shoferit, konsumimit të karburantit, dhe kohës së zgjatur të udhëtimit.

Në Tabelën 4.7 janë paraqitur nivelet e shërbimit për vonesat e kontrolluara mesatare për automjet për secilën grup të korsive të marrë për studim, të përmbledhura për secilin afrim në udhëkryq, dhe për tërë udhëkryqin [13].

Tabela 4.7: Përcaktimi i nivelit të shërbimit për udhëkryq të sinjalizuar

NSH (Niveli i shërbimit)	Vonesat e kontrolluara për automjet (s/aut)
A	≤ 10
B	$> 10 - 20$
C	$> 20 - 35$
D	$> 35 - 55$
E	$> 55 - 80$
F	> 80

4.7. Trajtimi i kthimeve majtas

Kthimet majtas mund të trajtohen si lëvizje me prioritet (me një lëvizje opozitare-ana e kundërt), si lëvizje të mbrojtura (me lëvizje të ndaluara të automjeteve opozitare), ose si një kombinim (fazë e përbërë). Plani fazor me i thjeshtë ka dy faza, një për secilin nga rrugët e kalimit.

Për një gjë të tillë, respektivisht për hapjen e shiritave të destinuara enkas për kthim majtas dhe vendosje të tyre në faza të veçanta brenda ciklit duhet që të plotësohet së paku njëri nga dy kriteret e mëposhtme sipas shprehjeve:

$$V_{km} \geq 200$$

$$x_{prod} = V_{km} \cdot V_0 / N_0 \geq 50,000 \quad (4.14)$$

Ku janë shënuar me:

V_{km} – Shkalla e vëllimit të qarkullimit të automjeteve për kthimet majtas, aut/h

V_0 – Vëllimi i qarkullimit të automjeteve nga ana e kundër (opozitare), aut/h

N_0 – Numri i shiritave (korsive) për levizjet opozitare.

Në Tabelën 4.8 janë dhënë vlerat ekuivalente për kthime majtas E_{km} ndërsa për kthime djathtas E_{kdj} që janë dhënë në Tabelën 4.9.

Tabela 4.8: Ekuivalenti i automjeteve për kthimet majtas, E_{km}

Qarkullimi opozitar	Numri i shiritave për qarkullim opozitar N_0		
	1	2	3
0	1.1	1.1	1.1
200	2.5	2.0	1.8
400	5.0	3.0	2.5
600	10.0	5.0	4.0
800	13.0	8.0	6.0
1000	15.0*	13.0*	10.0
≥ 1200	15.0*	15.0*	15.0

E_{km} për të gjitha kthimet majtas të mbrojtura = 1.05

Tabela 4.9: Ekuivalenti i automjeteve për kthimet djathtas, E_{kdj}

Qarkullimi i këmbësorëve në vendkalimet konfliktuoze	Ekuivalent
Nuk ka (0)	1.18
I vogël (50)	1.21
I mesëm (200)	1.32
I lartë (400)	1.52
Ekstrem (800)	2.14

Këto vlera janë në fakt një thjeshtësim i një qasje më komplekse në cilësinë e HCM të modelit të analizës për kryqëzimet e sinjalizuara, dhe ata formojnë një bazë të përshtatshme për kohën e sinjalizimit dhe dizajnimin [14].

4.8. Ndryshimi dhe intervalet e pastrimit

Ndryshimi dhe intervalet e pastrimit termat "ndryshim" dhe "pastrimin" të intervalit janë përdorur në një mënyrë të ndryshme në literaturë. Ata i referohen treguesve të verdhës dhe të gjithave të kuqeve përkatësisht që shënojnë kalimin nga e gjelbra për në të kuqe në çdo sinjal fazor. Intervallet e të gjithave të kuqeve është një periudhë gjatë së cilës të gjitha sinjalet tregojnë një tregues të kuq.

$$y = t + \frac{1.47 \cdot S_{85}}{2 \cdot a + (19.62 \cdot 0.01 \cdot G)} \quad (4.15)$$

Ku janë shënuar me:

y - gjatësia e intervalit të verdhë, s

t - koha e reagimit të shoferit, s

S_{85} - 85% i shpejtësisë së automjeteve që afrohet kryqëzimit, ose kufiri i shpejtësisë së e përshtatshme, km/h

a - ngadalësimi i automjeteve, m/s^2

G - pjerrtësia e rrugës, %

19.62 - dy herë nxitimi për shkak të graviteti, i cili është 9.81 m/s

Për rastet në të cilat nuk ka pak komunikacion të këmbësoreve:

$$ar = \frac{w + L}{1.47 \cdot S_{15}} \quad (4.16)$$

Për rastet në të cilat qarkullimi i këmbësorëve është domethënës dhe në rritje :

$$ar = \frac{P + L}{1.47 \cdot S_{15}} \quad (4.17)$$

Ku janë shënuar me:

ar - gjatësia e intervalit të gjithave të kuqeve, s

w - Distanca nga vija STOP e deri te pika me largët e konfliktit të automjeteve që janë në konflikt me automjetet e fazës tjetër. Kjo ndodh jo gjatë fazës së njëjtë ,m

P -Distanca nga vija STOP e deri te pika me largët e konfliktit të automjeteve që janë në konflikt me këmbësorët e fazës tjetër,m.

L - gjatësia e një automjeti standarde, zakonisht merret të jetë 5.5 m

S_{15} - 15 % i shpejtësisë me të cilat automjetet i afrohen hyrjes së kryqëzimit i afrohet ose kufiri i shpejtësisë, sipas rastit, km/h [14].

4.9. Përcaktimi i kohëve të humbura

Edicioni i HCM 2000 tregon se humbjet kohore ndryshojnë me kohëzgjatjen e dritës së verdhë dhe të gjitha të kuqeve gjatë sinjalizimit kohor. HCM tani rekomandon përdorimin e vlerave të mëposhtme:

- Humbjet kohore në start, $l_1 = 2.0 \text{ s /fazë}$
- Shfrytëzimi i të verdhës dhe të gjitha të kuqeve në fund të këtij intervali, $e = 2.0 \text{ s /fazë}$

Duke përdorur këto vlerat të përzgjedhura, humbjet kohore për fazë dhe koha e humbur për cikël mund të llogaritet si më poshtë:

$$l_2 = Y - e \quad (4.18)$$

$$Y = y + ar \quad (4.19)$$

$$t_L = l_1 + l_2 \quad (4.20)$$

Ku janë shënuar me:

l_1 – Humbjet kohore në start, s/faze,

l_2 – Humbjet kohore gjatë intervalit të pastrimit respektivisht intervalit të gjitha të kuqe, s/faze,

t_L – Humbjet kohore totale, s/faze,

y – Kohëzgjatja e intervalit të verdhë me rastin e ndryshimit, s,

ar – Kohëzgjatja e intervalit të pastrimit respektivisht të gjitha të kuqeve, s dhe

Y – Gjatësi totale prej intervalit të ndryshimit të verdhës dhe intervalit të pastrimit, s [14].

4.10. Përcaktimi i dëshiruar i kohëzgjatjes së ciklit

